

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7769 E diel 20 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Në përgjumjen e orëve të para të agut të djeshëm, teleshikuesit e televizionit "News 24" përjetuan tmerrin e një piskame ulëritëse të një nëne në mjerim ...
Vijon në faqen 21

Nga ILIR ÇUMANI

Piskama ulëritëse e një nëne...



Opinion i Ditës

Sipas Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT), 362 mijë është numri i atyre prej nesh që në tetë vitet e fundit (2011-2018) kemi lënë vendin tonë, në kërkim ...
Vijon në faqen 22

Nga FATOS ÇOÇOLI

Po boshatisemi!



Historia e të arrestuarit në "Volvo 4"

Kush është "Roni i Shijakut", njeriu që dyshohet se ideoi laboratorin e heroinës

I afërm me biznesmenin Admir Hoxha, 48-vjeçari akuzohet për drogën, shihet si "koka" e Avdylajve

Hekuran Hoxha, i cili u arrestua mbrëmjen e së premtes dyshohet se është koka e grupit "Avdylaj", që u godit në muajin tetor të vitit që shkoi në kuadër të operacionit të koduar "Volvo 4". Një ditë pas vënies në pranga, burime pranë grupit hetimor bënë me dije se dyshohet që 48-vjeçari që njihet edhe si "Roni i Shijakut" ...
Ne faqen 7

RISIA/ GAZMENT BARDHI SEKRETAR I PERGJITHSHEM, JA KUSH HYN NE KRYESI

EMRAT SURPRIZE, EKIPI I BASHES NE KRYE TE PD

Bujar Nishani në krye të Këshillit Kombëtar. Mbeten jashtë kryesisë Ervin Salianji, Pollo e Bumçi. Basha: Do nisim protestat për largimin e Ramës dhe qeveri transitore



(Në foto) Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, duke votuar për Këshillin Kombëtar

ARSIMI I LARTE
Kampusi universitar, Rama: Projekti përfundon brenda vitit 2023
Ne faqen 5

"CAMERIA, NDERI YNE"
Idrizi, kritika ndaj PD: Opozita të japë zgjidhje kundër qeverisë
Ne faqen 4

"AUDIO-INCIZIMI"
Akuza ndaj vëllait të Xhafajt për drogë, prokuroria pezullon hetimet
Ne faqen 6

INSPEKTIMET
Raporti i KLSH: Zonat në Shqipëri ku karburanti ka probleme cilësia
Ne faqen 11

SKEMA MASHTRUERE



Miliona euro vjedhje nga farmacistë të lidhura me zyrtarë të shëndetësisë
Ne faqen 8-9

MOZA


Nga Albert Nikolla: Pse diktatori e vinte shkrimtarin në radhë të dytë

"Kur sunduesit grinden", përballja Kadare-Hoxha

Në brendësi: "Tutori" i Moza Ahmetit. Parullat revolucionare nga Fan Noli

Nga ALBERT P. NIKOLLA

Botimi i fundit i I. Kadare's "Kur sunduesit grinden" është një sprovë tejet interesante mbi dinamikën antropologjike të marrëdhënieve diktator - artist nën diktaturën komuniste. Shpesh diktatorët kanë pasur



një marrëdhënie xhelozie me artistët. Shumë prej tyre, para se të merreshin me politikë e të bënin karrierë, janë marrë në mënyrë periferike me art. Stalini deri në moshën 17-vjeçare përpigëj të shkruante poezi, më vonë truri iu rreshk prej pasionit orëzi kriminal ...
Suplement

KËSHILLI KOMBËTAR ZGJEDHJET

Këshilli Kombëtar, protesta për largimin e Ramës dhe qeveri tranzitore për zgjedhje të lira

Strategjia, Basha: Sfida e PD-së, më e vështirë se në 1990

"PD s'do të jetë strehë për kriminelë"

Valentina Madani

Demokratët mbledhën dje Këshillin Kombëtar, i cili vendosi se zgjedhja e vetme në situatën e rënduar politike është krijimi i një qeverie kalimtare që do të ketë si detyrë përgatitjen e zgjedhjeve të barabarta. E deri në arrijeten e këtij qëllimi, aksioni kryesor i opozitës do të jenë protestat. Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, e quajti "emergjencë kombëtare" largimin e Edi Ramës. Para Këshillit Kombëtar, ku u votuan funksionarët që do të drejtojnë këtë parti në 4 vitet e ardhshme, Basha theksoi rëndësinë e miratimit të aksionit opozitar për largimin e Edi Ramës nga pushteti. Z.Basha foli për sfidat që e presin partinë e drejtuar prej tij, kur tha se ndryshimi i politikës mbetet një mision kombëtar. "Roli ynë, roli i demokratëve, i PD-së në këtë gjendje është kritik. Nuk është aspak e ekzagjeruar të them se sot para nesh shtrihet një detyrë historike. Nga ne sot kërkohet një ndryshim transformues, edhe më i vështirë se ai në fillim të viteve 1990-të", theksoi Z.Basha.

FTESA

Me ekipin e ri drejtues, i bindur është se do të largojë kryeministrin Rama, të cilin e akuzoi se e ka futur vendin në një krizë të thellë politike dhe ekonomike. Në përbushjen e këtij misioni u shpreh se i nevojitet bashkimi i qytetarëve, të cilët i ftoi të bëhen pjesë e protestave të thirrura nga opozita. "Nëse ka një pyetje me të cilën ndeshem ditë për ditë është: Kur do e rrëzoni Ramën, si do ta rrëzoni Ramën? Dua të jem i qartë. Unë dua ta rrëzojmë tani dhe kjo mund dhe do të arrihet vetëm në një mënyrë: duke i bërë njerëzit për vete, duke u ngjallur atyre besimin tek ne, që do t'i sjellë ata rreth nesh. Sa më shumë shqiptarët të bashkohen rreth nesh, aq më shpejt do bjerë Edi Rama. Nëse njerëzit do të kenë shpresë tek



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

JOZEFINA TOPALLI

Gjatë mbledhjes së Këshillit Kombëtar të PD-së ra në sy mungesa e ish-nënkryetarës Topalli, e cila është anëtare pas ndryshimeve statore që u realizuan në prill 2018. Por vetë Topalli deklaroi se nuk kishte marrë njoftim për mbledhjen e këtij forumi.

Shkrihet posti i sekretarit për aksionin qytetar

Saljanji: I zhgënjyer? Disa pa top apo me intrigë, unë luaj me zemër

Ervin Saljanji nuk do të jetë më sekretar i aksionit qytetar në PD, kjo pasi kreu i PD-së, Lulzim Basha vendosi ta shkrijë këtë post. Ai foli prerëse vëmendja e gjithëve duhet të jetë te protesta, te organizimi dhe synimin e madh që kanë përpara demokratët. Sipas tij, nuk është i rëndësishëm posti për të shërbyer dhe dhënë kontributin për demokratët dhe gjithë qytetarët. I pyetur nëse është i zhgënjyer, deputeti i PD foli për intriga, por jo për emra, por theksoi se do të kontribuojë fuqishëm në PD. "Jo, thashë që nuk kanë



asnjë rëndësi funksionet drejtuese. Unë jam kandidat për kryesinë e PD-së dhe jam sekretar i grupit parlamentar. Por, pa diskutim nuk ka rëndësi nëse luan pa top apo luan me intrigë, unë luaj me zemër dhe do të vazhdoj të

kontribuoj fuqishëm, edhe pa pasur asnjë funksion, si demokrat i thjeshtë, jo më që jam deputet dhe sekretar i grupit. Kështu që lajmi duhet të mbetet tek protesta", deklaroi Z.Saljanji. Ai shtoi më tej: "Po them që gjithçka që flitet në publik për njerëz të pakënaqur apo që mund të kenë objeksione të ndryshme për këtë Këshill, nuk besoj se janë të vlefshme, sepse nuk ka rëndësi funksioni për të qenë demokrat, për të shërbyer për demokratët, për të shërbyer për qytetarët".

kantë", theksoi Z.Basha.

ZGJEDHJA

Duke u ndalur tek propozimet që konkurruan dje për postet drejtuese të PD, Z.Basha i vlerësoi ata si njerëz të përkushtuar. Sipas tij, me zgjedhjen e kryesisë së re do të nisë puna për të një alternativë të fortë qeverisëse. "Një nga arrijetet e mëdha të PD-së dhe të këtij këshilli janë pikërisht njerëzit e propozuar që do të konkurrojnë për postet e lar-

ne, Edi Rama do të rrëzohet edhe formalisht, pasi moralisht dhe politikisht ka rënë me kohë. Ne kemi një rrugë për t'u përballur me këtë, është rruga e angazhimit të të gjithë qytetarëve, e bashkimit të të gjithë qytetarëve, për t'i dhënë fund kësaj fasade. Ka marrë një goditje fatale nga lëvizja studentore, duhet të marrë tani një goditje përfundimtare nga qytetarët e bashkuar", u shpreh kreu i PD-së. Kur foli

për bashkim, Basha nuk la mënjënjë edhe ftesën për këdo që dëshiron të japë kontributin e tij në PD. "PD është një parti e hapur dhe i mirëpret të gjithë ata që duan të bëhen pjesë e jona, të gjithë ata që duan ndryshimin, të gjithë ata që duan të kontribuojnë për të ndryshuar njëherë e përgjithmonë këtë lloj politikëbërje në Shqipëri. Por kur PD nuk do të jetë strehë për kriminelë e trafi-



Mbledhja e djeshme e Këshillit Kombëtar të PD-së

Nishani, në krye të Këshillit të PD, konfirmohen Spaho dhe Paloka

Ish-presidenti Bujar Nishani zgjidhet kryetar i Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike. Mbledhur për të zgjedhur strukturat e reja drejtuese, Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike votëbesoi në krye të tij, ish-presidentin Bujar Nishani, të cilin Lulzim Basha i besoi drejtimin e këtij forumi. 353 anëtarët e Këshillit rikonfirmuan në pozicionin e nënkryetarit të kësaj force politike, dy drejtuesit aktualë Edi Palokën dhe Edmond Spahon. Kurse Halim Kosova u zgjodh kreu i Komisionit të Integritetit Etikës në PD; Jemin Gjana zgjidhet kryetar i Komisionit Zgjedhor; Arben Ristani zgjidhet kreu i Komisionit të Apelit; Alfred Rushaj zgjidhet kreu i Bordit Financiar. Në kryesinë e PD, Basha ka propozuar kryesisht deputetë të PD. Ish-kryeministri Sali Berisha nuk është në kryesinë e Partisë Demokratike, pasi vetë ai ka dhënë dorëheqjen nga çdo strukturë të PD, përveç Këshillit Kombëtar.



ta drejtuese në parti përmes një procesi të hapur, demokratik dhe transparent. Janë që të gjithë demokratët të përkushtuar, të zotë, me integritet. Për t'ju përgjigjur sa më mirë sfidave që kemi përpara, për të vënë të gjithë kapacitetet tona në shërbim të realizimit të objektivave të PD-së kam vendosur të kemi një ndarje të funksioneve të deputeteve nga sekretariatit organizativ i partisë. Në këtë mënyrë organizimi i partisë nuk do të jetë i ndërvarur, por do të jetë i ndërthurur me betejat legjislativë dhe politike të deputetëve, apo detyrimi i tyre për të qenë sa më pranë

votuesve të tyre. Me kryesinë e re, ne do t'i përvishim mënjëherë punës për të krijuar një alternativë të fortë qeverisëse dhe një ekip të zotin dhe me dinjitet për të udhëhequr zbatimin e kësaj alternative", theksoi kreu i PD-së.

RRËZIMI

"Nëse ka një pyetje me të cilën ndeshem ditë për ditë është: Kur do e rrëzoni Ramën, si do ta rrëzoni Ramën? Dua të jem i qartë. Unë dua ta rrëzojmë tani dhe kjo mund dhe do të arrihet vetëm në një mënyrë: duke i bërë njerëzit për vete, duke u ngjallur atyre besimin tek ne, që do t'i sjellë ata rreth nesh", tha Z.Basha.



PD shpall rezultatet, Bardhi zgjidhet sekretar i përgjithshëm, Dollapi në vend të Bozdos

Këshilli Kombëtar zgjedh drejtuesit e PD, emrat e fituesve

Jashtë kryesisë Salianji, Bumçi, Boçi e Pollo

Valentina Madani

Partia Demokratike zgjodhi dje lidhshëm procesin e numërimit dhe përllogaritjes së rezultatit të votimit për sekretariatit dhe kryesinë e re të PD-së. Nga 355 anëtarë të Këshillit Kombëtar, në votim morë pjesë 328 anëtarë. Në një deklaratë për shtyp, nga selia e PD-së, kryetari i Komisionit Zgjedhor të PD-së, Jemin Gjana, prezantoi listën e fituesve në bazë të votave të marra nga secili kandidat. Sipas rezultateve të bëra publike nga Jemin Gjana, sekretar i përgjithshëm i PD-së u zgjodh Gazment Bardhi. Bardhi mori 277 vota përballë kandidati tjetër Dorian Teliti, i cili mori 44 vota. Ndërsa sekretar organizativ në PD u shpall me 285 vota Sait Dollapi. Në postin e sekretarit të çështjeve ligjore u zgjodh Çlirim Gjata me 284 vota, kurse në atë të sekretarit për burimet njerëzore, Ervin Minarolli me 278 vota. Ivi Kaso u zgjodh sekretar për çështjet zgjedhore. Në Këshillin Kombëtar të PD-së votuan 328 anëtarë nga 355 që janë në total.



Komisioni zgjedhor i Partisë Demokratike

EDI PALOKA

PD mori dje vendimin politik të organizimit të protestave në mbarë vendin. Nënkryetari demokrat, Edi Paloka, tha se Këshilli Kombëtar i PD-së i zgjedhur vendosi të ngarkojë strukturat drejtuese të partisë me organizimin e protestave për largimin e Edi Ramës.



Votimi

REZULTATI

Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike përmbylli dje procesin e numërimit dhe përllogaritjes së rezultatit të votimit për sekretariatit dhe kryesinë e re të PD-së. Nga 355 anëtarë të Këshillit Kombëtar, në votim morën pjesë 328 anëtarë.



Humbi garën, Teliti i uron suksese Bardhit

Pas shpalljes së rezultatit për votimet për postet drejtuese në Partinë Demokratike, reagoi dje kandidati për sekretar të përgjithshëm të PD-së, Dorjan Teliti, i cili humbi në këtë garë me Gazment Bardhin, i cili u shpall fitues. Sipas tij, "nga çdo garë brenda familjes sonë politike, ajo që fiton është Partia Demokratike". "Kënaqësi të garosh me një shok, koleg dhe patriot. Nga çdo garë brenda familjes sonë politike, ajo që fiton është Partia Demokratike. Suksese Gaz në detyrën e sekretarit të përgjithshëm!", shprehet z.Teliti në "Facebook".

KRYESIA

Ndryshime të thella pësoi dje lista e kryesisë së Partisë Demokratike, ku përmes votimit janë larguar disa figura të njohura dhe janë votuar emra të rinj. Nga 355 anëtarë të Këshillit Kombëtar, për zgjedhjen e kryesisë së re votuan 328. Kreu i Komisionit Zgjedhor në PD, z.Jemin Gjana publikoi mbrëmë emrat e fituesve Dhurata Çupi, Endri Hasa, Enkelejd Alibeaj, Enno Bozdo, Fatbardh Kadilli, Flamur Noka, Florjon Mima, Grida Duma, Izmira Ulqinaku, Jamarbër Mallezi, Jorida Tabaku, Kreshnik Çollaku, Oerd Bylykbashi, Orjola Pampuri dhe Tomorr Alizoti. Nga kryesia largohen Ervin Salianji, Aldo Bumçi, Roland Bejko, Geri Bogdani dhe Luçiano Boçi, që kanë rezultuar me vota të barabarta, por lista i ka përjashtuar për shkak

POSTET E ZGJEDHURA NGA KËSHILLI KOMBËTAR I PD-SË

- Kryetari i Këshillit Kombëtar, **Bujar Nishani** Kryetari i Komisionit të Integritetit dhe Etikës, **Halim Kosova**.
- Kryetari i Komisionit Zgjedhor, **Jemin Gjana**.
- Kryetari i Komisionit të Apelimit, **Arben Ristani**.
- Kryetari e Bordit Financiar, **Alfred Rushaj**.
- Nën.kryetar të PD: **Edi Paloka** **Edmond Spaho**

KRYESIA E RE E PARTISË DEMOKRATIKE

| | |
|------------------|------------------|
| Dhurata Çupi | Izmira Ulqinaku |
| Endri Hasa | Jamarbër Mallezi |
| Enkelejd Alibeaj | Jorida Tabaku |
| Enno Bozdo | Kreshnik Çollaku |
| Fatbardh Kadilli | Oerd Bylykbashi |
| Flamur Noka | Orjola Pampuri |
| Florjon Mima | Tomorr Alizoti |
| Grida Duma | |

VOTIMI PËR SEKRETARËT E RINJ TË PD-SË

Sekretar i Përgjithshëm: Gazment Bardhi 277 vota - Dorjan Teliti 44 vota, 7 vota të pavlefshme
Sekretar për Çështjet Ligjore: Çlirim Gjata 284 vota - Marinela Ziu 37 vota, 7 vota të pavlefshme
Sekretar Organizativ: Sahit Dollapi 258 vota - Lulzim Omuri 60 vota, 10 vota të pavlefshme
Sekretar për Çështjet Zgjedhore: Ivi Kaso 221 vota - Dorjan Gjonmarkaj 100 vota, 7 vota të pavlefshme
Sekretar për Burimet Njerëzore: Ervin Minarolli 278 vota - Minushe Lazaj 44 vota, 6 vota të pavlefshme

të respektimit të barazisë gjinore. Futen katër gra si Grida Duma, Dhurata Çupi, Orjola Pampuri dhe Izmira Ulqinaku. Gjana tha se ky ndryshim në listën e anëtarëve të rinj të kryesisë së PD është bërë sipas statutit. Vendimi i Lulzim Bashës për të thirrur Këshillin Kombëtar të PD-së dhe për të përzgjedhur lidhshëm e ri shënon edhe fundin e procesit të riorganizimit të PD-së, të nisur që pas humbjes së zgjedhjeve në vitin 2017. Ndryshe nga kryesia që funksionoi mandatin e parë të Bashës në krye të partisë, në të cilin anëtarët ishin pjesë e këtij organi për shkak të detyrave që mbanin, këtë herë më shumë se gjysma e anëtarëve do të votohen. Sipas statutit të ri të PD-së, të miratuar në prill 2018, anëtarët e Këshillit Kombëtar do të zgjedhin në kryesinë e PD-së me votim të fshehtë 15 anëtarë, nëpërmjet një numri kandidatësh të paktën sa dyfishi i numrit të vendeve vakante. Kryesia e re, e cila do të dalë nga votat e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të PD-së, do të ketë vendimmarrje të drejtpërdrejte në përzgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjet vendore. Statuti i ri i PD-së parashikon që kryesia të vendosë për kandidatët për kryetarë bashkie, kandidatët deputetë, pas konsultimit me anëtarësinë e plotë të PDSH-së sipas parimit "Një anëtar, një votë" dhe kandidatët për kryetarë të degëve të PDSH-së.

OPOZITA AKUZAT

Kreu i PDIU: Çamëria nderi ynë, Greqia i ka tentakulat në politikën shqiptare

Idrizi, kritika PD-së: Në pushtet, jo për të zëvendësuar një emër

"Opozita të japë zgjidhje kundër qeverisë"

Valentina Madani

PDIU e quan absurde venimin e PD-së për të dalë në protesta deri në rrëzimin e Edi Ramës nga pushteti. Pasi sipas Shpëtim Idrizit, opozita e bashkuar duhet të shpalojë platforma për të zgjidhur hallet e shqiptarëve, jo vetëm të denoncojë rastet flagrante të qeverisë. Kritikantët PDIU-së shkojnë përtej opozitës. Kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi, në aktivitetin për 28-vjetorin e themelimit të shoqatës "Çamëria" kritikoi dje vendimet e marra nga PD në mbledhjen e Këshillit Kombëtar. Sipas tij, rrëzimi i Ramës është detyrë e opozitës. Për kreun e PDIU-së, opozita sot duhet të japë alternativën e saj, se çfarë do të bëjë me arsimin, ekonominë, cilat është alternativa e saj për të qeverisur. "Studentët nuk duhet t'i linim vetëm. Opozita duhet të fuste kokën e shpirtin brenda për t'i mbështetur, u ngritën për përgjysmimin e taksave, prindërit e tyre s'kanë mundësi t'i çojnë në shkollë. Opozita duhet të ishte shprehë për ta, e bashkuar e qartë, duhet t'u jepte zgjidhje të gjitha pyetjeve. Çdo bëjnë me ekonominë, arsimin? Sot jo, nesër. Së këputoj dot si mund të merret vendim të heqë Ramën? Ka ndonjë detyrë të shpalojë platformën. Shqiptarët sot kanë nevojë për zgjidhje dhe opozita duhet të japë alternativën e saj pse do të vijë në pushtet, për të ndryshuar qeverisjen, jo vetëm për të zëvendësuar një emër", - theksoi Idrizi.



Kreu i PDIU, Shpëtim Idrizi

KRIKITA

"Së këputoj dot si mund të merret vendim të heqë Ramën? Ka ndonjë detyrë të shpalojë platformën. Shqiptarët sot kanë nevojë për zgjidhje dhe opozita duhet të japë alternativën e saj pse do të vijë në pushtet, për të ndryshuar qeverisjen, jo vetëm për të zëvendësuar një emër", - tha Idrizi.

"Të rinjtë, në protesta kundër Ramës"

Kryemadhi: LSI nuk ndalet, do demaskojë mashtrimet e qeverisë

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi takoi dje të rinjtë e LRI-së në Bashkinë Selenicë, ku bëri thirrje për t'u bashkuar në aksionin politik dhe kombëtar të opozitës: "Rrëzimin e klikës së kriminalizuar që ka marrë peng vendin dhe ka varfëruar shqiptarët". "Çdo stabilitet sot, pra çdo proces, çdo ngritje kundër këtij stabiliteti kriminal do të çlirojë Shqipërinë nga kësaj dhe nga varfëria, prandaj unë ju bëj thirrje që sot mos ndaloni, ku i keni miqtë, familjarët

tua në Tiranë, në Durrës, në Vlorë, në të gjithë Shqipërinë duhet t'i sensibilizojmë në mënyrë të tillë për të ecur përpara dhe për të rrëzuar këtë klikë, e cila ka marrë peng shqiptarët. Nuk është çështje rotacioni, nuk është çështje politike, nuk është çështje për të hequr një kryeministër dhe për të sjellë një kryeministër tjetër", tha Kryemadhi. Sipas saj: "Ne nuk mund të ngelemi më peng i këtyre mashtrimëve, por mbi të gjitha duhet të rrëzojmë këtë klikë, e cila po varfëron çdo ditë e më

shumë shqiptarët, ta rrëzojmë këtë klikë e cila çdo ditë dhe më shumë po bën shqiptarët më të lodhur, po i bën shqiptarët më të dobët, po i bën shqiptarët më me pa besim në vetvete. Prandaj edhe vendimi i opozitës së bashkuar është shumë i qartë, për të ecur përpara dhe për të sqaruar çdo qytetar shqiptar, për të qenë në protestë në ditët e ardhshme përpara kësaj klikë dhe përpara këtij individi që ka marrë peng shtetin, ka marrë peng vendin, ka marrë peng popullin shqiptar".

reja prapë për mandatin e Tiranës dhe Fierit se si janë manipuluar. Po tre që ngelën, ku janë? Imori i njëjti njeri. Unë do kërkoj falje para ju për ata që erdhën në PDIU, i morën të gjitha dhe e braktisën atë ditën e parë. Nëse prisni që Çamëria, PDIU, Shpëtim Idrizi t'ua sjellë Çamërinë të shtëpia, e keni gabim. Nuk kemi nisur për ta sjellë

këtë Çamërinë, por të shkojmë atje, në Çamëri, të bëhemi të gjithë bashkë", - theksoi Idrizi.

shqiptare, PDIU u bëri thirrje shqiptarëve që të jenë disporë të protestojnë për drejtat e çamëve, madje edhe para Kongresit Amerikan. Kreu i Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Shpëtim Idrizi ka përfutur 28-vjetorin e krijimit të shoqatës "Çamëria". Në fillim të tij, Idrizi tha se tentakulat e Greqisë kanë arritur që të



Kryeministri Edi Rama dje gjatë prezantimit të projektit të kampusit universitar

SHKURT

Meta përkujton kolegjin arbëresh: Studiuani De Rada dhe Gurakuqi

Presidenti Ilir Meta përkujtoi dje çeljen e kolegjit arbëresh "Shën Adrianit", institut arsimor që është ndjekur nga Jeronim de Rada, Luigj Gurakuqi si dhe Aleksandër Xhuvani. Meta theksoi në "Facebook" se ruan mbresa nga vizita që zhvilloi në nëntor të vitit të kaluar në këtë kolegji, teksa shoqërohej nga Presidenti e Italisë, Sergio Mattarella. "Si sot, në vitin 1734 u çel kolegji arbëresh i 'Shën Adrianit', që u kthye në një qendër të rëndësishme arsimore, kulturore dhe atdhetare të arbëreshëve të Italisë. Jeronim de Rada, Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani dhe një plejadë e vyer e shkrimtarëve e dijetarëve arbëreshë të ngulimeve të Kalabrisë e të Bazilikatës kanë ndjekur këtë institut arsimor, që nga rëndësia, roli dhe kontributi i tij në fushën kulturore, atdhetare dhe kombëtare është unik. Ruaj mbresa të shkëlqyera nga vizita historike në këtë kolegji së bashku me Presidentin e Italisë, Sergio Mattarella në nëntor të vitit të kaluar", shkruan Meta.

Vasili: Vetëpropozimi për ministër nga Rama, veprimi më idiot

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, ironizoi dje vendimin e kryeministrit Edi Rama për të qenë edhe ministër i Jashtëm. Vasili shkruan në "FB" se Rama të ishte vetëpropozuar edhe për 8 postet e tjera të ministrave. "Që propozimi i vetes për ministër nga Edi Rama është veprimi më idiot i pluralizmit shqiptar, këtë nuk e luan as topi. Që kryeministri Rama do t'i kërkojë hesap ministrin të Jashtëm Rama, edhe kjo është komedia më idiote, më e madhe e pluralizmit shqiptar. Ndonëse veprimi prej budalla, propozimi i vetes është veprimi më i singertë i Edi Ramës. Por që të ishte i singertë deri në fund, duhet të propozonte veten edhe për tetë postet e tjera të ministrave. Dhe do ishim rehat se do kishim një Rama kryeministër dhe 9 Rama ministra. Ky propozoi në fakt jo 8 ministra, por një 8 peçe këmbësh për këpucët e tija, 8 panolina për brekushet e tija, 8 kruajtëse dhëmbësh për gojën e tij. Në fund të llogarisë do duhej që kishim shumë ministra, por në fakt do të kishim vetëm një budalla të dalë nga mendët", tha Vasili.

depërtojnë brenda politikës shqiptare. "Tentakulat e Greqisë atëherë e sot janë brenda politikës shqiptare. Greqia nuk e heq ligjin e luftës, e kam thënë

sa e sa herë, ka qenë vallja e Zorbës për të marrë koncesionet e radhës. Do e heqin vetëm kur të kenë përballë një shtet shqiptar me dinjitet", tha z.Idrizi.

Njoftim për shitje me ankand të II

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dyle të pasurisë të palës debitore Shoqëria "GI PRA" sh.p.k. e përbërë nga:

- "ARE" - Nr pasurisë 31733, në Z.K.Nr. 2255, volumn nr.5, faqe 235, me sipërfaqe totale 7033 m², në Koxhas, Durrës. Ankand i fillim me cmim fillestar në masën 114,52 Euro.
- "ARE" - Nr. në pasurisë 314, në Z.K.Nr. 2255, volumn nr.1, faqe 212, me sipërfaqe totale 12 900 m², në Koxhas, Durrës. Ankand i fillim me cmim fillestar në masën 210.073, 92 Euro.
- "ARE" - Nr. pasurisë 313, Z.K.Nr. 2255, volumn nr.1, faqe 219, me sipërfaqe totale 4 300 m², në Koxhas, Durrës. Ankand i fillim me cmim fillestar në masën 70.024, 64 Euro.

Ankand do të zhvillohet në datë 4.02.2019 ora 15:00 në selisë "Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyrë nr.5 Kontakt tel. 0672082543, ilir.dervishaj@yahoo.com. WEB www.powerjustice-al.com

Njoftim për shitje me ankand të dyle

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenin 568, 577, e vijues të K.P.C shpall ankandin e dyle për pasurinë e palës debitore Sh "Strati Construcion" sh.p.k. "Pasuria përbehet nga:

- "Are" - Nr pasurisë 172223 ndodhur në Drac dhe Durrës, Z.K.Nr. 1522, volumn 3, faqe 249, me sipërfaqe totale 1.000 m². Ankand fillim me cmim fillestar në masën 2.240.000 leke
- "Apartment" - Nr pasurisë 116161-1-19 në Kryemadhin Kavajë, Z.K.Nr. 2291, volumni 23, faqe 42, me sipërfaqe 23.19 m². Ankand fillim me cmim fillestar në masën 1.064.000 leke.
- "Apartment" - Nr pasurisë 116161-1-20 në Kryemadhin Kavajë, Z.K.Nr. 2291, volumni 23, faqe 43, sipërfaqe 59,24 m² dhe Ankand fillim me cmim fillestar në masën 1.904.000 leke

Ankand qendron i hapur 30 ditë dhe do të zhvillohet në datë 4.02.2019 në orën 15:00 në Bulevardin "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyrë nr. 5 Tiranë. Kontakti tel. 00355 67 82 543 e-maili ilir.dervishaj@yahoo.com e WEB www.powerjustice-al.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA nr. 1/358, e llojit "Trrull dhe Ndërtëss" (godinë banimi dhe shërbime 3 kate e ndodhur në Ish-Fushën e Avacionit, TIRANË) me sipërfaqe të truallit 273 m² dhe sipërfaqe ndërtimi prej 200,2 m², Zona Kadastrale 8220, Vol. 23, Fq. 28, në pronësi të Znj. DENKE SEFERI.

ÇMIMI 25.472.989,70 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 14.02.2019.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .



SHKURT

Debati i Ramës me studenten, Berisha: Burracaku me antiplumb

Ish-kryeministri Sali Berisha reagoi dje pas një incidenti që ndodhi dje në takimin e kryeministrit Edi Rama me studentët teksa prezantonte projektin e kampusit universitar, si pjesë e Paktit për Universitetin. Përmes një postimi në "Facebook", Berisha ka sulmuar ashpër Ramën për sjelljen me studentët, pasi i kërkoi asaj të dilte jashtë nga salla, ndërsa e cilëson atë një burracak. Mes të tjerash, Berisha shton se Rama në takim ishte veshur me antiplumb. "Këtë i thonë dil jashtë debat! Akt arrogant dhe burracaku i Edvin Kristaq. Urrejties ndaj studentes, i cili i veshur me antiplumb në takim nxjerr jashtë studentin! Turp", - shkruan Berisha. Gjatë kohës që Rama fliste për kompusin, një studente e pranishme në sallë, u dëgjua të bërtiste se Pakti nuk është pranuar nga studentët, ndërsa i kujtoi kryeministrit se paguhej nga taksat e tyre. "Tani dil jashtë dhe ne vijojmë punën. Ju keni të drejta të ngriini probleme, por s'mund të përmbysni bashkëjetesën në një shoqëri. Ndërprerja e tjetrit, prishja e bashkëjetesës kur të tjerët janë mbledhur është mungesë aftësie për të bashkëjetuar në demokraci. Kush kujton se këtu jemi për të dëgjuar e duruar çdo lloj veshëgjatësie në emër të lirisë së studentëve, e ka gabim", tha Rama.

"Unaza", banorët: Rama, do të të japim litar të varësh veten

Në ditën e 76-të protestës, banorët e "Astirit" bllokuan sërish dje rrugën kryesore, ndërsa me thirrje dhe pankarta në duar kërkuan anulim të projektit dhe largimin e kryeministrit Rama. "Ka ardhur ora për të tërhequr zvarrë në boulevard, siç tërhoqëm Enver Hoxhën. Edhi Rama, erdhi ora, ik nga Shqipëria! Tani do të të japim litar të varësh veten. Ashtu do fshihesh edhe ti te bunkeri i Surrelit. Do vijë dita do të të tërheqim zvarrë Edhi Rama. Ke 76 ditë që na ke shkatërruar jetën. Unaza e bashkuar ka për të fituar. Edhi Rama kriminel. Na është bërë Shqipëria magazinë hashashi. Hajde po ta mbajti, hunjtë i kemi gati. Unë kisha vetëm dicka për t'i thënë kryeministrit, ne prapë do të të tërheqim zvarrë, se e ke mbushur Shqipërinë me korrupsion. Poshtë projektin!", u shpreh një nga banorët. Të pranishëm në protestë në mbështetje të banorëve, ishin edhe deputetë e opozitës.

Incidenti, kryeministri përzë studenten pasi e ndërpreu: Suksese, dil jashtë!

Kampusi universitar, Rama: Projekti mbaron brenda 2023

"Studentët duhet të shkojnë në mësim"

Në prag të zgjedhjeve vendore, kur e gjithë vëmendja është e përqendruar në rikandidimin e mundshëm të kryebashkiakut Veliaj për Bashkinë e Tiranës, kryeministri Rama foli dje për një mandat tjetër të kryetarit të bashkisë, por sërish u la vend dyshimeve. I bindur se PS do të fitojë Bashkinë e Tiranës në zgjedhjet e 30 qershorit, Rama tha se kampusi universitar do të përfundojë brenda mandatit tjetër të kryetarit të bashkisë, por nuk përmendi asnjë emër mbi kandidatin konkret. "Ajo që mbetet ambicia jonë është që brenda këtij mandati, të gjitha konviktet të jenë në një situatë katërcipërisht ndryshe dhe ndërkohë, së bashku me Bashkinë e Tiranës, ne të fillojmë ndërtimin e këtij kampusi dhe brenda mandatit tjetër të kryetarit të bashkisë, të përfundojmë kampusin universitar", deklaroi z.Rama. Kryeministri së bashku me kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliaj inspektuan dje godinat e konvikteve në Qytet Studenti, të cilat i janë nënshtruar së fundi rikonstruktimit. Rama u ndal edhe te një nga godinat e konvikteve në QS, ndërsa gjatë bashkëbisedimit me studentët e pranishëm, i këshilloi të shkojnë në mësim. "Vetëm duhet të shkoni në mësim se nuk do bëjmë dot dhomat", u tha Rama studentëve. Nga ana tjetër, kryebashkiaku Veliaj tha se janë të paktën 2000 dhoma që kanë nevojë për ndërhyrje në total në Qytet Studenti. Kujtojmë që dje, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve prezantoi Draft-Paktin për Universitetin, i hartuar nga Këshilli i Ministrave, si një mënyrë për t'u dhënë zgjidhje kërkesave të studentëve dhe fund bojkotit të mesimit.



KAMPUSI
Projekti i kampusit universitar parashikon rindërtimin e godinave ekzistuese që ka nisur tashmë, si dhe ndërtimin e 11 godinave të reja, një mense, terrene sportive si dhe një bibliotekë më të madhe. Rama premtom se realizimi i projektit do të mundësohet brenda mandatit të ardhshëm të kryebashkiakut të Tiranës.

Kryeministri sulmon ish-presidentin për zaptim tokash

Nishani padit Ramën, i akuzoi të vëllanë se ktheu në loto mensën në QS

Kryeministri Edi Rama teksa prezantoi dje projektin e kampusit universitar, hodhi akuzë në drejtim të ish-presidentit Bujar Nishani për zaptim tokash. "Simboli i këtij zaptimi është Nishani Studenti. Nishani e sfidon Edhi Ramën, si njeriu që ka në dorë çdo pushtet dhe çdo zyrë publike, nga tatimet te hipoteka, të bëjë publike dokumentet që provojnë se vëllai i ish-presidentit është pronar i ish-mensës në Qytetin Studenti apo ka kryer ndonjë aktivitet lotoje aty. Pronarët e vërtetë që ballarët e këtyre që sot vje-

di dorëzoi një padi në adresë të kryeministrit për shpifje. Ish-presidenti siguroi se i vëllai as nuk ka tentuar, as nuk ka nuk ka privatizuar kurrë ndonjë objekt në Qytetin Studenti. "Nishani e sfidon Edhi Ramën, si njeriu që ka në dorë çdo pushtet dhe çdo zyrë publike, nga tatimet te hipoteka, të bëjë publike dokumentet që provojnë se vëllai i ish-presidentit është pronar i ish-mensës në Qytetin Studenti apo ka kryer ndonjë aktivitet lotoje aty. Pronarët e vërtetë që ballarët e këtyre që sot vje-

dhin shqiptarët, ua sekuestruan e grabitën për 50 vjet. Sot jo vetëm i mbysin me taksa, gjoba e gjithfarëlloj maskarallëqesh, por dhe u përgojnë pronat duke ua veshur të tjerëve pa lidhje", thuhet në njoftimin e PD-së. Pak kohë më parë, për të vërtetuar se e njëjta akuzë ishte shpifje, ish-presidenti Nishani publikoi certifikatat e pronësisë së pronarëve të ligjshëm, që nuk kanë asnjë lidhje me familjen apo të afërm të tij.

demokratë se janë bërë pengesë për realizimin e këtij projekti. Arsyeya e sinkronizuar që japin kryeministri dhe kryebashkiaku janë legalizimi i ndërtimeve pa leje brenda territorit të Qytetit Studenti. Rama gjeti rastin t'u ripërsërisë kundërshtarëve të Ligjit të Arsimit të Larte se ai nuk preket. Jo të paktën derisa argumentet që ata sjellin, sipas tij, të jenë bindëse. Projekti i kampusit universitar parashikon rindërtimin e go-

dinave ekzistuese që ka nisur tashmë, si dhe ndërtimin e 11 godinave të reja, një mense, terrene sportive, si dhe një bibliotekë më të madhe. Rama premtom se realizimi i projektit do të mundësohet brenda mandatit të ardhshëm të kryebashkiakut të Tiranës.

mërive. Ndërsa kryeministri mbante fjalën e tij e fliste për një proces transformimi të universiteteve, një studente e pranishme në sallë u dëgjua të bërtiste se Pakti nuk është pranuar nga studentët, ndërsa i kujtoi Ramës se paguhej nga taksat e tyre. "Tani dil jashtë dhe ne vijojmë punën, ju keni të drejta të ngriini probleme, por s'mund të përmbysni bashkëjetesën në një shoqëri.", -tha Rama.

NJOFTIM

Në datë 05.02.2019 në orën 16.00 në zyrën e përbaruesit gjyqësor privat Irlisa Tereziu PF me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njësia Tregtare nr.10, Tiranë", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Trull+Ndertese" me sip. Trulli 220m2 dhe sip.ndertese 97 m2, me nr.pasurie 11/23, vulum 10, faqe 229, zona kadastrale 8503, ndodhur ne Lagjia "Jani Vruho", Berat.Cmimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 2,296,000 (dy milion e dyqind e nentëdhjete e gjashte mije) lekë.

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA
Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e TRETË , për shitjen e pasurisë së paluajtshme për te cilen ka vene hipotekë NBG BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:
Lloji i pasurisë Are+ Trull (magazine dy kate) me sip. arë 3000 m2 / trull 16611 ndertese 234.9, me nr.pasurie 589 vol 8 1q78, zk.1475 , Derven, KRUIJE në pronësi të Haki Ahmet HAKIRI/CMIMI me të cilin fillon shitja në ankand është 60.480 (gjashtëdhjetë mije e katërqind e tetëdhjetë) EUR
Ankandi zhvillohet në datën 15.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me Adrese: Boulevardi "Bajram Curri", Pall. 21.Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270899

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA
Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e PARE , për shitjen e pasurisë së paluajtshme për te cilen ka vene hipotekë NBG BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:
Nr. 1/387-N1, ZK. 8562, VOL.30, FAQ. 91 e lloji njesi me sip. 109 m2 ndodhur ne adresën Rruga "Fuat Babani", Korçë ne pronesi te Pandoli Borja.
Ne vleren 69.760 EUR, gjashtëdhjete e nente mije e shatërqind e gjashtëdhjete) EUR
Nr. 1/387-N3, ZK. 8562, VOL.30, FAQ. 93 e lloji njesi me sip. 89.2 m2 ndodhur ne adresën Rruga "Fuat Babani", Korçë ne pronesi te Pandoli Borja.
Cmimi me të cilin fillon ankandi është ne vleren 57.088 EUR, pesëdhjete e shtata mije e tetëdhjete e teta) EUR
Ankandi zhvillohet ne daten 04.02.2019, ne përfundim te orarit zyrtar, ora 16:30 ne zyrën e përbaruesit gjyqësor, me Adrese: Boulevardi "Bajram Curri", Pall. 21.Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270899

TIRANË - Një 20-vjeçar është plagosur me armë zjarri pasditen e djeshme në zonën e Yzberishtit në Tiranë. Burime zyrtare nga policia e kryeqytetit bënë me dije se i riu që u qëllua është Klorentin Shehu, i cili menjëherë është dërguar në Spitalin e Traumës, ku dhe i është dhënë ndihma e parë mjekësore. "Rreth orës 17:40, në zonën e Yzberishtit, pas një konfliktit të çastit është plagosur me



Plagoset me armë zjarri 20-vjeçari në Yzberisht, identifikohet dhe shpallet në kërkim autori

armë zjarri në këmbë një i rreth 20 vjeç, jashtë rrezikut për jetën. Policia ka identifikuar autorin dhe po punon për kapjen dhe vënien e tij para përgjegjësisë ligjore", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkaq, burime për "Gazeta Shqiptare" pohuan se 20-vjeçari Shehu është

përfshirë në konflikt me një person tjetër, emri i të cilit nuk bëhet me dije. Në sherr e sipër, dy të rinjtë janë përleshur me njëri-tjetrin dhe për pasojë, Klorentin Shehu ka marrë një plumb në trup. Krismat e armëve kanë shkaktuar panik tek banorët e zonës, ndërsa menjëherë në

vendngjarje kanë mbërritur uniformat blu dhe kanë nisur hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje. Pas hetimeve paraprake, policia ka identifikuar autorin e krimin dhe është vënë në ndjekje të tij. Gjithashtu, policia ka ushtruar kontroll në banesën e

autorit të ngjarjes, por ai nuk është gjendur aty. Ndërkaq, materialet në lidhje me këtë ngjarjeje priten t'i kalojnë prokurorisë për hetime të mëtejshme për veprat penale "Vrasje dhe mbetur në tentativë" dhe "Armëmbajtje pa leje".

Dosja rikthehet në polici, me qëllim kryerjen e veprimeve të tjera hetimore

Klodiana Lala

TIRANË

Prokuroria për Krime të Rënda pezulloi dhe ktheu në polici dosjen penale, në kuadër të së cilës po verifikonte rolin e Agron Xhafajt, vëllai i ish-ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, për përfshirje të mundshme në një rrjet trafikimi ndërkombëtar droge. Çështja penale u çel pas akuzave të vlonjatit Albert Veliu, i njohur me nofkën "Babale". Skandali që po hetohet shpërtheu pas publikimit nga ana e Partisë Demokratike të një materiali audio, ku një person i identifikuar si "bashkëpunëtori x", fliste për një bashkëpunim të mundshëm me vëllain e ministrit të Brendshëm të kohës, për të trafikuar hashash nga Shqipëria drejt Italisë. Më vonë, personi në fjalë u zbulua se ishte Albert Veliu, i njohur edhe si Berti i Abesë, ish-i dënuar për trafik droge. Të njëjtat akuzat për Agron Xhafajn, Albert Veliu i bëri edhe përmes një interviste dhënë gazetarit Jetmir Olldashi, e cila gjithashtu u transmetua nga selia e Partisë Demokratike. Mbi këtë bazë, Prokuroria për Krime të Rënda nisi hetimet për të zbuluar nëse ishte vërtet përpara një rasti të trafikimit të narkotikëve. Por, pas

"Babale", Prokuroria e Krimeve të Rënda pezullon hetimet për trafik droge

Nuk ka prova të ngarkojnë me përgjegjësi penale vëllain e ish-ministrit të Brendshëm, Geron Xhafajin

SKANDALI

Çështja penale u çel pas akuzave të vlonjatit Albert Veliu, i njohur me nofkën "Babale". Skandali që po hetohet shpërtheu pas publikimit nga ana e Partisë Demokratike të një materiali audio, ku një person i identifikuar si "bashkëpunëtori x", fliste për një bashkëpunim të mundshëm me vëllain e ministrit të Brendshëm të kohës për të trafikuar hashash nga Shqipëria drejt Italisë.



Albert Veliu

shumë muajsh hetime, institucioni i akuzës nuk ka mundur të grumbullojë prova, mbi bazën e të cilave të

ngarkojë me përgjegjësi penale ndonjë person, përfshirë këtu edhe vëllanë e ish-ministrit të Brendshëm. Në

këto kushte, prokurori Përpamir Kulluri ka firmosur për pezullimin e hetimeve. Dosjen në fjalë e ka kthyer

në polici, me qëllim kryerjen e veprimeve të tjera hetimore. Ndërkohë, më herët Krimet e Rënda zbuluan se audiopërgjimi ishte i rremë dhe se zërin e Agron Xhafajt e kishte realizuar Fredi Alizoti. Ky i fundit, së bashku me "Babalen" dhe gazetarin Jetmir Olldashi po hetohen për akuzën e kallëzimit të rremë. Alizoti ndodhet nën masën e arrestit me burg, ndërsa Albert Veliu u arratis në Kosovë dhe mundi t'u shpëtonte prangave. Në fund të dhjetorit "Babalja" u arratis edhe nga Kosova përmes Hungarisë dhe sipas avokatit të tij mbërriti në Belgjikë, ku i është bashkuar pjesës tjetër të familjes dhe ka kërkuar azil politik. Në gjendje të lirë po hetohet gazetari Jetmir Olldashi.

Plagosja e djalit të prezantueses italiane, gjykata dënon me 5 vjet burg shqiptarin

ITALI - Është mbyllur gjykimi i parë para gjykatës të Milanos Guido Salvini, procesi me gjykim të shkurtuar për sulmin ndaj Niçolo Bettarini, djali 20-vjeçar i ish-futbollistit Stefano Bettarini dhe prezantueses televizive Simona Ventura, i cili u qëllua me thikë, shqelma dhe grushte 1 korrikun e kaluar jashtë diskotekës "Old Fashion" në Milano, ku ai kishte kaluar natën me një grup shokësh. "Ka përfunduar një makt. Drejtësia është bërë", tha i riu i cili u



Niçolo Bettarini

muar synimin tashmë të shprehur për të hequr dorë nga dëmshpërblimi prej 200 mijë eurosh. "Dënime të drejta. Kjo është ajo për të cilën luftuam deri në fund", shpjegoi avokatja e të riut. Ai që është dënuar me shumë, me 9 vjet është 29-vjeçari Davide Caddeo, i cili akuzohet se e ka qëlluar 8 herë me thikë djalin e prezantueses italiane. Dënime të ndryshme për tre të pandehurit e tjerë: 5 vjet dhe 6 muaj për Alessandro Ferzoco, 6 vjet dhe 6 muaj për Albano Jakej dhe 5 vjet për shqiptarin Andi Arapi, i vetmi që nuk

kishte precedentë penalë dhe që dje ka lënë qelitë për të vuajtur dënimin me arrest shtëpie. Për tre prej tyre u dha edhe ulja e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar. Siç u tha në vendim, të tre donin ta rrihnin Bettarini dhe jo ta vrisnin dhe mungon prova që ishin në dënim se Caddeo, i cili është dënuar me 9 vjet, kishte me vete një thikë. Sipas asaj që u dëshmuar në gjyq, Ferzoco dhe shoqja e tij kishin pasur në ditët e mëparshme një grindje në një lokal tjetër me një mik të Bettarinit. Përplasja që është ringjallur atë



Stefano Bettarini, Simona Ventura dhe djali i tyre, Niçolo Bettarini

natë të parë të korrikut në "Old Fashion". Dhe Caddeo iu bashkua miqve të Ferzocos atë mbrëmje, por askush nuk e njihje mirë. Gjykatësi gjithashtu ka urdhëruar transmetimin në prokurori të dëshmimeve në

gjyqin e Niçolo edhe të dy miqve e tij, duke përfshirë një vajzë që hyri në sherr për ta shpëtuar atë dhe një tjetër djalë i ri. Prokurori Elio Ramondini, i cili kishte kërkuar 10 vjet burg për të gjithë.

Prokuroria: Në 2003-2004 trafikoi nga Shqipëria në Itali 488 kg drogë

DURRËS

Hekuran Hoxha, i cili u arrestua mbrëmjen e së premtes dyshohet se është koka e grupit "Avdyllaj", që u godit në muajin tetor të vitit që shkoi në kuadër të operacionit të koduar "Volvo 4". Një ditë pas vënies në pranga, burime pranë grupit hetimor bënë me dije se dyshohet që 48-vjeçari që njihet edhe si "Roni i Shijakut" ishte personi që dyshohet se luante rolin kryesor në trafikimin heroinës, që prodhohej në laboratorin e Hasit. Po të njëjtat burime thanë se Hoxha dyshohet se drejtonte trafikun e drogës nga Shqipëria drejt vendeve të tjera të Europës. 48-vjeçari është i afërm me biznesmenin Admir Hoxha, personi që ideoi dhe financoi ngritjen e laboratorit të prodhimit të heroinës në fshatin Brenog të Hasit, ku u gjetën 250 kg lëndë narkotike dhe ku u arrestuan 5 persona. Sipas prokurorisë, Saimir Gjepali, (i shpallur në kërkim) dhe Hekuran Hoxha janë dy kontaktet e biznesmenit Hoxha, që akuzohet si njeriu që financoi ngritjen e laboratorit të drogave të forta. Biznesmeni vazhdon ende të jetë në kërkim nga policia, së bashku me dy shtetas turq dhe një kosovar që punonin për prodhimin e heroinës në laborator. Ndërkaq, burime zyrtare nga policia mbrëmë bënë me dije shtetasi në fjalë u kap, pasi më 17 janar të këtij viti, prokuroria ka lëshuar urdhër ndalimi ndaj tij. Ai dyshohet për kryerjen e veprave penale: "Prodhim dhe shitje e narkotikëve", "Trafikim i narkotikëve", "Prodhim dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope, në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal", "Grup i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal" si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale". Një hetim i Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe antimafiles italiane ka zbuluar se Hekuran Hoxha në bashkëpunim me persona të tjerë kanë mundur që gjatë

Trafiku i drogës, "Roni i Shijakut", porositi i heroinës në fshatin Brenog të Hasit

48-vjeçari, i afërm me biznesmenin Admir Hoxha, që ideoi dhe financoi ngritjen e laboratorit



48-vjeçari i arrestuar, Hekuran Hoxha



SHKURT
Operacioni, arrestohen 2 tregtarët e poligjishëm

LEZHË - Policia e Lezhës ka arrestuar në kuadër të operacionit "Fake grains" dy persona që tregonin artikuj industrialë pa faturë e dokumente, me vula e stampa të falsifikuar. Nga hetimet disajvare të ndjekura nga seksioni kundër krimit ekonomik dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe pas informacione të siguruar në rrugë policore, u bë i mundur realizimi i operacionit në fjalë, ku u vunë në pranga shtetasit: A.N. vjeç 50 dhe E.B. vjeç 34, banues në Tiranë. Mësohet se personat e mësipërm u kapën me mjetin e tyre me një sasi artikujsh për t'i tregtuar në lokale e gytetit të Lezhës. Malli i bllokuar dyshohet pa asnjë dokument shoqërimi apo faturë tatimore, me vula e stampa të falsifikuara, pasi të drejtën e pronësisë së tregtimit të asaj marke e ka një shoqëri tjetër tregtare e regjistruar. Veprat penale për të cilat akuzohen janë "Shkelje e të drejtave të pronësisë industriale", "Fshehja e të ardhurave", "Prodhim i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale e ushqimorë", "Manipulim i tregut" dhe "Falsifikim i vula e stampave".

Mbytet jahti në detin Jon, shpëton italiiani

SARANDË - Një jaht është mbytur dje pranë brigjeve të detit Jon. Ngjarja në fjalë u sinjalizua rreth orës 11:30, kur motoskafi lëshoi alarmin "SOS, ndërsa drejt tij u nisën menjëherë tri mjete hundruese të forcave të Policisë Kufitare. Mësohet se mjeti i lundrimit, 16 metra i gjatë, ishte nisur nga Korfuzi drejt Sarandës, por fatkeqësisht ai pësoi defekt 5 milje larg bregut, në vendin e quajtur "Kapogefal". Burime policore bënë me dije se jahti ishte me flamur holandez, ndërsa ai drejtohej nga një shtetas italian. Ndërhyrja e menjëhershme e policisë ka bërë që të shpëtohet kapiteni i skafit, 40-vjeçari G.D. nga Napoli. Pasi është shoqëruar në komisaratin e Sarandës, ai ka deklaruar se ishte nisur për turizëm dhe se udhëtonte i vetëm me jahtin e tij.

AKUZAT

Burime zyrtare nga policia bënë me dije shtetasi në fjalë u kap, pasi më 17 janar të këtij viti, prokuroria ka lëshuar urdhër ndalimi ndaj tij. Ai dyshohet për kryerjen e veprave penale "Prodhim dhe shitje e narkotikëve", "Trafikim i narkotikëve", "Prodhim dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope, në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal", "Grup i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal" si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale".

viteve 2003-2004 të trafikimin nga Shqipëri në Itali 488 kg heroinë. Mes personave të këtij grupi ka qenë edhe Alket Hatija. Përveç Italisë, grupi është akuzuar për trafik

dogrash të forta në Itali dhe në Turqi. Hekuran Hoxha është arrestuar edhe në vitin 2009 bashkë me katër persona të tjerë, si të dyshuar për trafikimin e sasisë prej 488 kg

OPERACIONI "VOLVO 4"

Mbrëmjen e 21 tetorit të vitit 2018, FNSH dhe RENEA në kuadër të operacionit të koduar "Volvo 4" prangosën 24 persona, mes të cilëve Avdyllaj e Shijakut si dhe ish-deputetët Arben Ndoka dhe Arben Çuko, emrat e të cilëve dolën nga përgjimet e bandës së Shijakut me banda të tjera në Shqipëri. Policia arrestoi 5 persona për laboratorin e heroinës në Has, dy prej të cilëve u liruan nga gjykata, pasi rezultuan se ishin punonjës. Ndërkohë, në kërkim vijojnë të jenë ende dy shtetas turq.

heroinë nga Shqipëria drejt Italisë. Në atë kohë, bashkë me Hekuran Hoxhën u prangosën edhe Alket Hatija i njohur si "Zoti i drogës", Fatbardh Hoxha, Mentor Shehu dhe Saimir

Gjepali, që të gjithë nga Shijaku. Gjithashtu, ai është arrestuar edhe në vitin 2011 si pjesë e një grupi që trafikonte heroinë nga Turqia drejt Europës.

Ishin futur në një tenxhere me gjellë

Sekuestrohen 3 celularë në burgun e sigurisë së lartë në Lezhë

LEZHË - Sofistikohen përditë e më shumë mënyrat me të cilat tentohet të futen në burgje sende të ndaluara. Ditët e fundit në burgun e sigurisë së lartë në Lezhë, policia e burgjeve mes sendeve që tentoheshin të futeshin në qeli ka zbuluar se në një tenxhere ishin fshehur 3 celularë dhe aksesoret përkatës. Mësohet se tenxherja ishte e mbushur me gjellë (fasule) dhe poshtë kishte një fund të dyfishtë. Punonjësit e policisë së burgjeve i kanë bërë një

kontroll të imtësishëm dhe kanë mundur të zbulojnë celularët e fshehur, megjithëse fundi i dyfishtë ishte maskuar shumë mirë. Materialet e çështjes i kanë kaluar prokurorisë së rrethit për të vijuar hetimin e kësaj çështjeje dhe zbulimin e autorëve të saj. Ky nuk është rasti i parë, kur sendet e ndaluara si celularë apo drogë synohet të futen në burgje me mënyra të sofistikuara. Pak muaj më parë në burgun e Lezhës policia kapi një top futbollit të fryrë, që u hodh nga jash-



të rrethimit të burgut dhe që në brendësi kishte 3 celularë. Burime nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve bëjnë të ditur se vetëm gjatë muajit janar 2019 policia e burgjeve ka mundur të kapë 15 celularë që tentonin të futeshin, apo ishin futur në burgje.

Dy vëllezërit plagosin 42-vjeçarin në Fier, kapet njëri

FIER - Një 42-vjeçar është plagosur rëndë me thikë në Fier, ndërsa aktualisht ndodhet në Spitalin e Traumës në Tiranë në kujdesin e mjekëve. Ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e së premtes në mjediset e jashtme të një lokali në fshatin Pojan të Fierit, ku 42-vjeçari me iniciale E.A. është goditur me mjete të forta. Pas ngjarjes, blutë arrestuan 21-vjeçarin D.G.J. si dhe po punohet për kapjen e vëllait të tij 27-vjeçar, që dyshohet autorë të ngjarjes. Sipas policisë, dy vëllezërit në bashkëpunim me njëri-tjetrin për motive të dobëta kanë goditur me mjete të forta 42-vjeçarin. Ndërkohë, mësohet se dy agresorët e kanë goditur, pasi një ditë më parë i plagosuri është zënë me babain e tyre që punon taksist. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprën penale "Plagosje e lehtë me dashje" e kryer në bashkëpunim.



ABUZIMI NE SHENDETESI SKANDALI

Biznesi familjar/ Si e "grabitën" buxhetin të afërmit e drejtuesve të FSDKSH


Dhjetëra miliona euro dëme nga rimbursimet mashtruese

Si përfituan familjarët e zyrtarëve shtetërorë

Në fund të korrikut 2014, duke folur në një konferencë përpara mjekëve të shërbimit parësor në Tiranë, ish-ministri i Shëndetësisë, Ilir Beqaj denoncoi një numër farmacish dhe mjekësh, që sipas tij manipulonin skemën e rimbursimit të barnave.

"Ky është mjeku B.T në Shkozë, 80% e recetave të tij përfundojnë tek farmacia 'Geni&Lori'. Shkoza ka 10 farmaci, por njëra prej tyre, 'Geni&Lori' merr 4/5 e recetave që rimbursohen", tha Beqaj në prani të ish-drejtorit të FSDKSH, Astrit Beci, duke nënvizuar se kjo skemë mashtrimi ishte e shpërndarë në të gjithë Shqipërinë. Një vit më vonë, në qershor 2015, bazuar në një raport të iniciuar nga Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit në Kryeministri, Prokuroria e Tiranës procedoi penalisht 9 persona - përfshirë ish-drejtorin e Fondit për Tiranën, Pjerin Xhuvani, të akuzuar për favorizimin e 4 farmacive, që nëpërmjet recetave të falsifikuara kishin përfituar në mënyrë të paligjshme 56 milionë lekë. Skandali çoi në dorëheqjen e kreut të Fondit, Astrit Beci, por farmacia 'Geni&Lori' në pronësi të kumatës së ish-nëndrejtorit të FSDKSH-së në atë periudhë, Sokol Skura, nuk u penalizua. Dokumentet e siguruar nga BIRN tregojnë se farmacia 'Geni&Lori' nuk ishte e vetmja farmaci në pronësi të familjarëve të Skurës dhe Skura nuk ishte i vetmi zyrtar i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, FSDKSH, familjarët e të cilit kanë në pronësi farmaci që përfitojnë shumën marramendëse rimbursimi çdo vit.

Pesë farmaci të tjera, të lidhura me dy kompani në pronësi të ish-kontrollorit të Fondit, Gazmend Aliaj, njëherazi kunati i drejtorit të Politikave në FSDKSH, Aleksandër Haxhi, kryesojnë listën e përfituesve gjatë dekadës së fundit. Të



Skema e lidhjes së zyrtarëve shtetërorë me farmacitë përfituese

dhënat e rimbursimit të barnave të analizuar nga BIRN tregojnë se nga vitit 2010 deri në vitin 2018, vetëm farmacitë në pronësi të familjeve Aliaj dhe Skura kanë siguruar rimbursime që janë disafish më të larta se mesatarja dhe kapin në total një vlerë prej 13.9 milionë euro. Këto farmaci janë denoncuar disa herë në Prokurori për "mashttrim me subvencionet", por hetimet janë mbyllur pa nxjerrë përgjegjësi penale. Në anën tjetër, shkeljet e kon-

statuara nuk e kanë penguar Fondin që të rilidhë vit pas viti kontrata për rimbursimin e barnave me këto subjekte, me gjithë shqetësimet e vazhdueshme të ngritura nga Kontrollori i Lartë i Shtetit. Farmacitë në pronësi të familjeve Skura dhe Aliaj nuk janë të vetmet që përfitojnë vlera të larta rimbursimi nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Të dhënat e analizuar nga BIRN tregojnë se gjatë dekadës së fundit, dy duzina

farmacish nga një listë prej gati 850 subjektësh në kontratë me Fondin, kanë përfituar vlera rimbursimi disa herë mbi mesataren. Së bashku, 24 farmacitë kryesuese përfituan 36.6 milionë euro nga viti 2010 deri në prill 2018; ose 9.4 për qind të vlerës totale të rimbursimeve. Vlera e lartë e rimbursimit nuk do të thotë automatikisht që këto subjekte kanë shkelur ligjin. Por auditet e vazhdueshme të ndërmarra KLSH kanë zbuluar se kontrolli që Fondi ushtron ndaj



MILVA EKONOMI
Ish-ministria e Ekonomisë, Milva Ekonomi, e cila zëvendësoi Astrit Becin në korrik 2015, duke u emëruar si drejtor e komanduar në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor i tha BIRN se kontrollon ndaj farmacive shpesh dekonspirueshin nga punonjës të Fondit.

pak fjalë jam mërziur shumë. Të jem realist deri në atë kohë nuk kisha dëgjuar ndonjëherë një ministër të receta patientësh, por me politika të larta në zhvillim të sistemit shëndetësor", shtoi ai.

RRJETI FAMILJAR I FARMACIVE
Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor u themelua në vitin 1995 si një institucion që kishte për qëllim financimin e shërbimeve shëndetësore në formën e një skeme publike. Njëzet vjet më vonë, kjo skemë e financuar nga një tarifë e barabartë me 3.4% të pagës të çdo punëmarrësi në vend, financon shërbimet shëndetësore në nivele të ndryshme nga ofrures publike dhe private.

Në vitin 2017, Fondi kishte një buxhet prej 39.4 miliardë lekë, nga të cilat 11.3 miliardë lekë erdhën nga kontributet e sigurimeve shëndetësore dhe 28 miliardë lekë nga buxheti i shtetit. Nga ky buxhet, 20 miliardë lekë u shpenzuan për shërbimin e kujdesit spitalor; 8 miliardë lekë për shërbimin shëndetësor parësor dhe 10 miliardë lekë për rimbursimin e barnave. Lista e barnave të rimbursueshme është një nga paketat më të rëndësishme që financonet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor. Ky rimbursim realizohet në bazë të kontratave që Fondi lidh çdo vit me subjektet farmaceutike në vend. Gjatë vitit 2017, Fondi kishte kontrata me 848 farmaci, 74 agjenci farmaceutike, 14 spitale dhe 19 burje. Gjatë këtij viti, Fondi shpenzoi 3.7 miliardë lekë për rimbursimin e farmacive spitalore dhe 6.7 miliardë lekë për rimbursimin e rrjetit të hapur të farmacive private.

Fondi publikon në bazë mujore vlerën e rimbursimit të përfituar nga çdo sub-

"ILAÇI"

Padia e Brahos, suplementi "NeuroAid" dhe veteranët

Më 14 prill 2016, Prokuroria e Tiranës mori një kallëzim të ri nga Fondi për veprat penale të "falsifikimit të dokumenteve shëndetësore", "mashttrimit" dhe "mashttrimit me subvencionet", i cili rridhte nga një kontroll i ushtruar në Drejtorinë e Fondit në Tiranë në nëntor 2015. Në kallëzimin penal drejtuar prokuror-

isë, ish-drejtoresha e FSDKSH-së, Vjollca Braho kërkoi fillimin e hetimeve dhe procedimin penal të disa farmacive dhe mjekëve për rimbursimin në periudhën qershor-tetor 2015 të një suplementi të quajtur "NeuroAid II MLC901", për kategorinë e veteranëve të luftës. "Nga verifikimi i bërë në regjistrin 'online' të Agjencisë Ko-

mbëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore rezultoi se ky produkt nuk është 'bar' nuk është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe si i tillë nuk mund të rimbursohet, gjë që i ka shkakuar një dëm ekonomik për muajt qershor-tetor 2015 me një vlerë totale prej 14.3 milionë lekësh", shkruante Braho.

farmacie me rimbursim më të lartë se 2 milionë lekë në muaj ka qenë i papërshtatshëm dhe në shkelje të rregulloreve të institucionit. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor nuk iu përgjigj pyetjeve të detajuara të BIRN. Ish-kontrollori i Fondit, Gazmend Aliaj gjithashtu nuk i përgjigj një kërkesë për intervistë, ndërsa kunati i tij Aleksandër Haxhi nuk ishte i arritshëm për koment. Ndryshe nga Aliaj, ish-nëndrejtori i Fondit, Sokol Skura i tha BIRN se ai ishte hetuar nga disa institucione publike, por në fund kishte dalë i pastër. "Të ardhurat relativisht të mira të dy farmacive të mia justifikohen nga furnizimi i mirë me barna, për të cilat unë tatohem dhe jap të gjitha të dhënat çdo muaj pranë institucioneve përkatëse", tha Skura. "Jam hetuar nga ILDKPKI, nga hetimi tatarimor, nga Fondi kam pasur një kontroll të plotë dhe kam dalë i pastër", shtoi ai. Skura kundërshtoi gjithashtu akuzat e ish-ministrit Ilir Beqaj, duke e përshkruar këtë të fundit si të keq-informuar. "Unë kam qenë prezent në sallë gjatë deklaratës së ish-ministrit Ilir Beqaj dhe mendoj se nuk ka pasur dijeni që ka qenë farmacia e vëllait tim", tha Skura duke iu referuar mbledhjes së korrikut 2014. "Atë ditë jam bërë tym, me



KONTROLLE SELEKTIVE

Në 18 mars 2015, kryeministri Edi Rama firmosi një urdhër të brendshëm që autorizonte kontrollin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, lidhur me zbatimin e procedurave ligjore në përzgjedhjen e distributorëve farmaceutikë, lidhjen e kontratave dhe zbatimin e tyre.

jekt farmaceutik privat me të cilin ka kontratë. Këto të dhëna statistikore janë të publikuara në faqen në internet të Fondit për një periudhë që fillon nga viti 2010 deri në prill të vitit 2018 (muajin vetëm vlerat e rimbursimit për periudhën janar-mars 2015). Me qëllim analizimit dhe identifikimit e përfuttesve në të mëdhenj të skemës së rimbursimit të barnave, BIRN i hodhi të dhënat e publikuara nga Fondi në një bazë të dhënash. Të dhënat e analizuar nga BIRN tregojnë se nga viti 2010 deri në prill të vitit 2018, FSDKSH shpenzoi 48.8 miliardë lekë (390.8 milionë euro) për rimbursimin e ilaçeve, fond nga i cili përfituan rreth 850 subjekte farmaceutike. Nga kjo listë, një grup prej 24 subjektesh, që përbëjnë 2.8% të farmacive me kontratë në vend kanë përfituar 9.4% të fondit ose 36.6 milionë euro nga viti 2010 deri në prill 2018. Lista e subjekteve përfituese udhëhiqet nga një grusht farmacish të lidhura me drejtorin e politikave në Fond, Aleksandër Haxhi dhe kunatin e tij Gazmend Aliaj, si dhe ish-nëndrejtorin e FSDKSH-së,

Sokol Skura. Përpara se të bëheshin pronarë farmacish, Skura dhe Aliaj kanë punuar si kontrollorë në drejtorinë e Fondit për Tiranën. Të dhënat e Fondit listojnë 5 farmaci, të cilat janë ose kanë qenë në pronësi të Gazmend Aliajt dhe bashkëshortes së tij, Iris Aliaj. Gjatë dekadës së fundit, bashkëshortët Aliaj nëpërmjet farmacive 'Nikol 1', 'Nikol 2', 'Nikol 2-IRA', 'Bio Plus' dhe 'Medigreen' kanë qenë farmacistët me rekordin më të lartë të rimbursimeve, duke arkituar 974 milionë lekë (7.75 milionë euro) nga FSDKSH.

Farmacitë e lidhura me ish-nëndrejtorin e Fondit, Sokol Skura renditen në vend të dytë. I rritur në Librazhd, Skura i tha BIRN se ishte diplomuar për Farmaci në vitin 2002, duke ndjekur profesionin e të atit. Ai ka punuar si kontrollor i Fondit për 4 vjet, përpara se të hapte farmacinë e tij të parë 'Coli's' në vitin 2007, në afërsi të ambulancës numër 9, tek lagja e njohur si ish-Parku i Autobusëve në Tiranë. Sipas Skurës, biznesi është rritur vit pas viti "duke punuar me përkushtim". Paralelisht me biznesin farmaceutik, Skura ka ndjekur dhe ambicinet e tij politike. I mbështetur edhe nga kreu i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, me të cilin kishte miqësi që nga koha e gjimnazit në Librazhd, ai u zgjodh anëtar i Asamblesë Kombëtare të PS në vitin 2011 dhe në vitin 2013 kandidoi për një vend në Parlament si përfaqësues i zonës së Librazhdit. Skura nuk u zgjodh deputet, por pas zgjedhjeve u emërua zv.drejtor i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Përveç farmacisë 'Geni&Lori', që është në pronësi të kumatës së tij, Loranda Skura, Sokol Skura ka në pronësi farmacitë

Rrjeti ka lidhje me ish-drejtes të Fondit të Sigurimit Shëndetësor

"Receta për personat e vdekur": Farmacitë, nën akuzë për mashtrim

"Rimbursim kundër ligjit për gjoja 400 veta"

Vladimir Karaj

Një rrjet farmacish të lidhura me ish-drejtes të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor janë nën akuzë për mashtrim me rimbursimet përmes recetatave të falsifikuara në emër të personave të vdekur ose atyre që jetojnë jashtë Shqipërisë. Prokuroria e Tiranës njoftoi të premtën se pjesë e skemës së dyshuar të mashtrimit janë farmacitë "Bioplus" dhe "Medigreen" në pronësinë e Gazmend Aliajt si dhe farmacia "Geni&Lori" në pronësinë e Loranda Skurës. Prokuroria e Tiranës njoftoi gjithashtu se kishte lëshuar urdhër-arreste për Petrit Skurën dhe Gazmend Aliajn. Megjithatë, urdhër-arrestet nuk janë ekzekutuar ende pasi asnjëri prej tyre nuk është gjetur në vendbanesë nga policia.

Procedimi penal për skemën e mashtrimit me ilaçet e rimbursimeve u regjistrua në qershor 2018 me akuzën e "shpërdorimit të detyrës". Prokurori Ervin Karanxha tha se policia e Tiranës kishte bërë një referim të dytë në Prokurori, pas publikimit të një investigimi të BIRN në nëntor 2018, që ekspozonte një rrjet farmacish në pronësi të familjarëve të drejtuesve të Fondit, të cilat kishin përfituar shuma marramendëse rimbursimi për gjatë 10 viteve të fundit. "Nga hetimet e kryera na ka rezultuar se farmacitë e mësipërme kanë lëshuar recetat dhe kanë përfituar rimbursime në emër të personave të vdekur apo të personave që jetojnë jashtë Shqipërisë", tha Karanxha për BIRN. "Pjesë e këtij procedimi janë edhe persona të tjerë, të cilët po hetohen në gjendje të lirë", shtoi prokurori. BIRN mësoi se vetëm për një periudhë 5-mujore, farmacitë e mësipërme kanë rimbursuar recetat për rreth 400 persona në kundërshtim me ligjin, ndërkohë që vlera e rimbursimit për çdo recetë varionte deri në 30 mijë lekë.

| | | | | | | |
|---------------|-------------|--------|--------|--------------|--------------|----------|
| ALFA | Eni | KLODI | Lule | Maja | NEFRI | Nacional |
| BARDHI HSB | Eri | | | | | |
| Colis | Fama | | | Shehu | Sokrat Pifti | Spathu |
| Diana | Flora | | | Stela | | Teuta |
| Eleni Shufeng | Geni & Lori | | Ilir 1 | Suzana Bosi | | Vera |
| Elec | Jun | Rubini | | | | Zenelaj |
| | | Shakaj | | Tahiri-Krymi | | |

...Janë pajisur me recetë në mënyrë të përsëritur nga 2 deri në 5 herë shtetas, të cilët kanë qenë të vdekur. Konkretisht rezultuan se ndodhen 79 recetat të rimbursuara dhe 35 shtetas/pacientët, të cilët janë pajisur me ilaçe disa herë, ndonëse këta persona rezultojnë të vdekur në regjistrin e gjendjes civile", tha Prokuroria. Verifikime janë kryer edhe përmes sistemit TIMS, të cilat kanë zbuluar se recetat fiktive janë lëshuar edhe në emër të personave që nuk jetojnë në Shqipëri.

Në një investigim të botuar në nëntor 2018, BIRN zbuloi se një rrjet farmacish të

hetuara më parë për mashtrim me subvencionet dhe në pronësi të familjarëve të ish-drejtesve të Fondit kryesonin listën e rimbursimeve të ilaçeve në dhjetë vitet e fundit, duke ngritur dyshime për favorizim dhe konflikt interesi. Farmacitë "Bioplus", "Medigreen" dhe "Geni&Lori" janë pjesë e këtij rrjeti farmacish.

Petrit Skura është babai i ish-nëndrejtorit të FSDKSH, Sokol Skura, ndërsa Gazmend Aliaj është kunati i drejtorit të Politikave në Fond, Aleksandër Haxhi. Përpara se të bëheshin pronarë farmacish, Sokol Skura dhe Gazmend Aliaj kanë punuar si kontrollorë në drejtorinë e Fondit për Tiranën.

Të dhënat e analizuar nga BIRN tregojnë se nga viti 2010 deri në prill të vitit 2018, FSDKSH shpenzoi 48.8 miliardë lekë (390.8 milionë euro) për rimbursimin e ilaçeve, fond nga i cili përfituan rreth 850 subjekte farmaceutike. Nga kjo listë, një grup prej 24 subjektesh, që përbëjnë 2.8% të farmacive me kontratë në vend kanë përfituar 9.4% të Fondit ose

36.6 milionë euro nga viti 2010 deri në prill 2018. Lista e subjekteve përfituese udhëhiqet nga një grusht farmacish të lidhura me drejtorin e politikave në Fond, Aleksandër Haxhi dhe kunatin e tij Gazmend Aliaj, si dhe ish-nëndrejtorin e FSDKSH-së, Sokol Skura. Gjatë dekadës së fundit, bashkëshortët Aliaj nëpërmjet farmacive 'Nikol 1', 'Nikol 2', 'Nikol 2-IRA', 'Bio Plus' dhe 'Medigreen' kanë qenë farmacistët me rekordin më të lartë të rimbursimeve, duke arkituar 974 milionë lekë (7.75 milionë euro) nga FSDKSH. Farmacitë e lidhura me ish-nëndrejtorin e fondit, Sokol Skura renditen në vend të dytë. Përveç farmacisë 'Geni&Lori', që është në pronësi të kumatës së tij, Loranda Skura, Sokol Skura ka në pronësi farmacitë 'Coli's' dhe 'Eurofam2'. Në total gjatë 8 viteve të fundit, tri farmacitë në pronësi të familjes Skura - 'Geni&Lori', 'Eurofam2' dhe 'Coli's' kanë përfituar 765 milionë (6 milionë euro) lekë rimbursime nga FSDKSH. Në një intervistë për BIRN në nëntor 2018, Sokol Skura ia dedikoi suksesin e farmacive të tij përkushtimit në punë, ndërsa Gazmend Aliaj nuk iu përgjigj një kërkesë për intervistë. "Të ardhurat relativisht të mira të dy farmacive të mia justifikohen nga furnizimi i mirë me barna, për të cilat unë tatoheh dhe jap të gjitha të dhënat çdo muaj pranë institucioneve përkatëse", tha Skura. "Jam hetuar nga ILDKPKI, nga hetimi tatumor, nga Fondi kam pasur një kontroll të plotë dhe kam dalë i pastër", tha ai.

'Coli's' dhe 'Eurofam2'. Në regjistrin tregtar gjenden dy shoqëri me emër tregtar 'Coli's' me pronar Skurën. Një subjekt i regjistruar në 2007 në formën e personit fizik, i cili është regjistruar në vitin 2013 dhe një shoqëri me përgjegjësi të kujdesit, e quajtur gjithashtu 'Coli's'. Shoqëria me përgjegjësi të kujdesit 'Coli's' është regjistruar në vitin 2013 me pronarë znj. Elga Gogu, bashkëshortja e Sokol Skurës. Në janar 2014, aksionet e kësaj shoqërie i janë transferuar Elida Gogut, vzhjerrës

së z.Skura, me vlerë nominale prej 100 mijë lekë. Në vitin 2015, vjehrra e Z. Skuraj ia transferon aksionet z.Erdis Alikajt përsëri për vlerën e tyre nominale prej 100 mijë lekësh. Në 29 qershor 2017, shoqëria 'Coli's' sh.p.k ka përhithur farmacinë 'Eurofam2', e regjistruar gjithashtu në emër të Erdis Alikajt. Shoqëria e krijuar nga bashkimi, me emër tregtar 'Coli's', 'Eurofam2', 'Pharmalider', është shitur në vitin 2018 nga Erdis Alikaj tek Sokol Skura për vlerën nominale të aksioneve prej 200 mijë le-

kësh. Transaksionet e shumta brenda familjes të aksioneve të farmacisë 'Coli's' ngrënë dyshime se mund të kenë pasur si qëllim maskimin e marrëdhënies së z.Skura me këtë shoqëri gjatë periudhës që ai mbante postin e zv.drejtorit të Fondit. Në total gjatë 8 viteve të fundit, tri farmacitë në pronësi të familjes Skura - 'Geni&Lori', 'Eurofam2' dhe 'Coli's' kanë përfituar 765 milionë (6 milionë euro) lekë rimbursime nga FSDKSH. Në një intervistë me

BIRN, Skura mohoi të ketë favorizuar farmacitë në pronësi të tij apo të familjarëve gjatë periudhës që ai ka punuar si zv.drejtor i FSDKSH-së. Ai tha BIRN që gjatë kësaj periudhe, farmacia 'Coli's' "ka qenë dhe është biznes familjar", dhe para se të fillonte detyrën ia ka transferuar në fillim vjeprës dhe pastaj djalit të hallës, Erdis Alikaj, duke shmangur konfliktin e interesit.

* **Botuar në 'reporter.al' nëntor 2018. Marrë me shkurtime**

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Raporti i KLSH-së kërkon rritje të numrit të inspektimeve, arkëtimi i gjobave vjen në rritje

Karburanti në Shqipëri, jashtë standardit

Akset më problematike, Tiranë-Durrës-Elbasan dhe Fier-Vlorë-Berat

Një raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka zbardhur zonat ku janë hasur më dendur mostrat e karburantit jashtë standardeve në gjithë territorin e vendit. Analiza e KLSH, e kryer vitin e shkuar, bazohet te kontrollat e ushtruara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në subjektet treguese me pakicë të karburanteve. ISHTI ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimesh, të cilat janë rritur nga viti në vit: 6641 inspektime për 2015, në vitin 2016 janë kryer 7561 inspektime duke arritur numrin më të lartë 10,887 në vitin 2017. Zonat më problematike, të cilat kanë numrin më të lartë të mostrave me tregues jashtë standardit janë Tiranë-Durrës-Elbasan dhe Fier-Vlorë-Berat. Përgjatë kësaj periudhe, sipas KLSH janë vendosur penalitete sipas viteve 2015, 2016 dhe 2017 përkatësisht: 271, 257 dhe 76 gjoba, të cilat ndjekin trendin e uljes së subjekteve me tregues të mostrave jashtë standardeve të cilësia,

TAKSAT

Shqipëria është një ndër vendet me taksat më të shumta që paguhen në një litër naftë. Pavarësisht kësaj, qeveria nuk ka bërë ndryshime as për vitin 2019 pasi në paketën fiskale nuk parashikohet asnjë ndryshim i tillë. Për një litër naftë shqiptarët paguajnë rreth 120 lekë për litër më shumë se në çdo vend tjetër të rajonit. Shqiptarët paguajnë më shumë se i gjithë rajoni taksa për karburantin.



C'KËRCON BIZNESI

Në fund të vitit të kaluar, "Biznes Albania" kërkoi uljen e akcizës së naftës dhe benzinit që përdoret për transportin në industrinë e prodhimit në Shqipëri. Aktualisht sipas përlogaritjeve të bëra nga sipërmarrësit, çmimi është 57% më i lartë se mesatarja në botë.

ku arkëtimi i tyre vjen në rritje, megjithëse ngelet problematik arkëtimi vullnetar i vlerës së gjobave. Ndërkohë që në analizën e vetë Kontrolli i Lartë i Shtetit konkludon se numri dhe cilësia e inspektimeve është e mangët, pasi vetë Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ka mungesa në infrastrukturën e nevojshme (makinat, karburant, pajisje kompjuterike dhe internet),

si dhe të zyrave rajonale, për kryerjen e inspektimeve.

TAKSAT NE SHQIPERI

Shqipëria është një ndër vendet me taksat më të shumta që paguhen në një litër naftë. Pavarësisht kësaj, qeveria nuk ka bërë ndryshime as për vitin 2019 pasi në paketën fiskale nuk parashikohet asnjë ndryshim i tillë. Për një litër naftë shqiptarët

paguajnë rreth 120 lekë për litër më shumë se në çdo vend tjetër të rajonit. Shqiptarët paguajnë më shumë se i gjithë rajoni taksa për karburantin. Nga një përlogaritje konstatohet se për një litër karburant rreth 115-120 lekë janë vetëm taksa dhe sado të ulët çmimi i naftës ky nivel është i pandryshueshëm. Kostove u shtohet dhe transporti si dhe pagesat e punonjësve dhe

qiratë. Por edhe TVSH që në Shqipëri shkon në 20 për qind, nuk aplikohet në asnjë vend të botës në këtë nivel.

Në Maqedoni konstatohet se taksat që aplikohen për një litër naftë janë vetëm dy TVSH dhe akcizë dhe pesha fiskale është dyfish më e ulët se në Shqipëri. Por, përtej kësaj ajo që vihet re në Shqipëri e që nuk paguhen në asnjë vend të botës janë taksa e

garkullimit dhe ajo e skanimit dhe markimit. Situata pritet të mbetet e njëjtë dhe në vitin 2019. Pavarësisht ankesave të biznesit dhe drejtuesve të automjeteve, në paketën fiskale nuk u bë reduktimi i asnjë prej 7 taksave që prekin karburantet. Konfidustria ndërkohë ka propozuar që të ulët me 50% taksa e garkullimit dhe e dyta të ndërhyjë tek cilësia. Për ta shkak i ndotjes së mjedisit është pikërisht karburanti i keq.

Flet kryetari i shoqatës së Industrialistëve Ushqimorë, Alban Zusi

"Me pagën minimale dhe zhvlerësimin e euros kemi humbur avantazhin konkurrues"

PRITSHMERITE PER 2019

Në vitin 2019, ne presim një qasje tjetër të qeverisë për konsultimin publik-privat. Shpresojmë që qeveria të ndryshojë sjelljen e saj me biznesin. Rasti më i fundit ishte ritja e pragut për pagën minimale pa u konsultuar me grupet e interesit. Rritja e pagës, në mendimin tim, duhet të vijë nga tregu", - tha Alban Zusi.

bizneset dhe do të tkurrë më tej hapësirat për investim dhe për të shtuar vende të reja pune. Një tjetër problematikë që ka prekur sektorin tonë, duke qenë se një pjesë e jona është edhe eksportues, është zhvlerësimi i euros. Uroj që euro të rikuperojë nga humbjet e këtij viti. Për shkak të humbjeve nga kursi i këmbimit, kompanitë në industrinë agroushqimorë janë rezervuar në investim. Një pjesë e industrisë ka rritur çmimet me klientët. Normat e

fitimit për kompanitë e sektorit do të ishin zero, në rast se ne nuk do të rrisnim çmimet për klientët tanë. Megjithatë, duhet të shtoj se rritja e çmimit nuk ka amortizuar të gjithë humbjet nga zhvlerësimi i valutës. Vendimi për rritjen e pagës minimale në mënyrë të papritur, por edhe zhvlerësimi i euros, e ka bërë ekonominë më pak konkurruese në tregjet rajonale. Aktualisht nuk është një klimë e mirë për të bërë biznes në vend, pasi biznesi pengohet me gjëra ab-

surde dhe nuk merren në konsideratë shqetësimet tona. Mendoj që ka ardhur momenti i krijimit të një instituti që harton politikat ekonomike në vend, në mënyrë shkencore dhe të pavarur. Deri më tani, politikantët kanë qenë të pamenduar, duke vënë në vështirësi biznesin.

Çfarë do të sjellin ndryshimet në Paketën Fiskale për industrinë ushqimore në vend?

Nga Paketa Fiskale kemi marrë goditjen më të madhe, që është ulja e TVSH-së për fermerin në 6% nga 20% që u vendos në vitin 2014. Për sektorin tonë kjo do të jetë goditja e dytë pas euros. Me këtë vendim rriten kostot për lëndët e para të produkteve vendase me 14%, duke i bërë ato jo konkurruese.

Si mund të përfitojë Shqipëria nga taksa që u ka vendosur prodhimeve serbe dhe boshnjake Kosova?



Kryetari i shoqatës së Industrialistëve Ushqimorë, Alban Zusi

Embargo e vendosur nga qeveria e Kosovës për produktet serbe dhe boshnjake ka dhënë efekt tek eksportet shqiptare drejt Kosovës. Megjithatë, rritja është e pandjeshme, për shkak të barrierave që ekzistojnë, të cilat pengojnë garkullimin dhe hyrjen në treg të prodhimeve për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme.

Kostoja e tranzitimit nga një shtet në tjetrin është shumë e lartë, gjë që e bën të pamundur në nivelin e bizneseve të vogla të mesme dhe të produkteve të freskëta për të përfituar nga kjo hapësirë që është krijuar tashmë në tregun e Kosovës. Ky vendim po jep ndikim tek eksportet e produkteve që tregtojnë bizneset e mëdha.

Zhvlerësimi i euros është një nga faktorët kryesorë që ka ndikuar në uljen e konkurrenshëmrisë së produkteve shqiptare. Disa prej kompanive në industrinë agropërpunuese, të cilat eksportojnë jashtë, janë detyruar të rrisin çmimet, në mënyrë që të përballojnë humbjet. Ulja e TVSH-së për fermerët nga 20% në 6% do të sjellë shtrënjtimin e lëndëve të para për sektorin. Alban Zusi, kryetar i Shoqatës së Industrialistëve Ushqimorë, thotë për "Monitor" se kjo është një goditje e dytë.

Si e prisni vitin 2019?

Në vitin 2019, ne presim një qasje tjetër të qeverisë për konsultimin publik-privat. Shpresojmë që qeveria të ndryshojë sjelljen e saj me biznesin. Rasti më i fundit ishte ritja e pragut për pagën minimale pa u konsultuar me grupet e interesit. Rritja e pagës, në mendimin tim, duhet të vijë nga tregu. Rritja e pagës minimale, me urdhër administrativ, do të rrisë kostot për

DEBATI

Tërhiqet projekti i teatrit? Çipi: S'ka më përralla me arkitektë të huaj

Fatmira Nikolli

Zyra e shtypit në Ministrinë e Kulturës: Nuk kam informacion

Regjisori pas 200 ditësh protestë: Afatet ligjore skaduan më 13 dhjetor

Arkitekti danez i projektit të shumëdebatuar për Teatrin Kombëtar, Bjark Ingels, është tërhequr. Prej dy ditësh ky është lajmi që qarkullin në media. Deri më sot nuk ka pasur as konfirmim, as përgënjeshtim. "GSH" ka kontaktuar zyrën e shtypit Ministrisë së Kulturës për çështjen, por zëdhënësja është shprehur se nuk ka informacion. Gjatë këtyre dy ditëve, një lajm i publikuar në "Exit.al" thotë se firma "Bjarke Ingels e arkitektit danez me të njëjtin emër është tërhequr nga projekti për ndërtimin e Teatrit Kombëtar. Tërheqjen e kanë konfirmuar për "Exit.al" burime të sigurtat.

I kontaktuar nga "Gazeta shqiptare", ish-drejtori i Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", regjisori Kastriot Çipi tha dhe se ai nuk ka një informacion të sigurt nëse Ingels është tërhequr. Si një prej artistëve që ende qëndron në protestë, Çipi tha se, "kompania nuk e ka konfirmuar, por vetë fakti që nuk e përgënjeshtrojnë do të thotë diçka". Sipas tij, ky është në fakt truku. "Ky është një tjetër hap pas i qeverisë, e cila nuk mund të dalë më e nuk mundet të fryjë opinionin publik me përrallë e një arkitekti të huaj, të njohur ndërkombëtar, vepra e të cilit në Tiranë do të ishte një pikë



atraksioni turistik. Nuk mund ta thonë më, se kështu na u servir", - tha dhe Çipi. Megjithatë, regjisori thotë se fakti që Ingels mund të jetë tërhequr, mund të çojë edhe të delegimi i punës ose dhënia e projektit një arkitekti shqiptar. "Nuk do të ishte hera e parë. Ka ndodhur edhe më herët që projekte të nisura nga të huaj janë bërë nga arkitektë shqiptarë. Shiten të huajt sa për të mashtruar dhe dalin ustallarët shqiptarë", tha Çipi. Nga ana tjetër, ai

shtoi se që prej datës 13 dhjetor ka skaduar afati ligjor për të shpallur garën për projekte për Teatrin Kombëtar dhe ka skaduar edhe afati për të ngritur komisionin përzgjedhës. "Nuk mund të nxirren akte të tjera nënligjore për teatrin. Sepse do ishte shkelje ligjore", - shtoi Çipi. Marsin e vitit të kaluar kryeministri Edi Rama ka publikuar në Kryeministri me ceremoni mes një grupi të zgjedhur artistësh, projektin e hartuar nga

Ingels për Teatrin e ri Kombëtar. Që paracaktuar që realizimi i projektit do të bëhej nga një kompani, përmes një ligji special. Ndërsa projekti u bë publik në mars, protesta kundër shembjes së Teatrit Kombëtar aktual kishin nisur që në shkurt. Artistët më të njohur qenë vënë para godinës të bindur për ta mbrojtur deri në fund. Në takime të përjavshme, protesta e artistëve veçse përshkallëzohej. Me kalimin e muajve, artistët u përçanë, por de-

batet mes mbrojtësve të të Teatrit dhe mbështetësve të qeverisë u thelluan. Projekti parashikonte shembjen e dy teatrove kombëtarë të vendosur në një sipërfaqe prej 9 mijë metrash katrorë, për të ndërtuar një teatër të vetëm në tri kate. Artistë e pjesëtarë të shoqërisë civile u ankuar se trualli i teatrit po humbet, duke iu dhënë privatit. Ligji special u kritikua nga shumë grupe interesi, si edhe nga Bashkimi Evropian si shkelje e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA). Qeveria, nga ana e saj ngulmonte se nuk ka buxhet të mjaftueshëm për të ndërtuar një teatër të ri me paratë e taksapaguesve dhe se për këtë arsye, trualli i teatrit do i jepej privatit dhe se do të ishte privat që do e ndërtonte teatrin me paratë e tij. Ligji kaloi në parlament më 5 korrik, por nuk u dekretua nga presidenti, i cili i ktheu në komisionin parlamentar. Por në komisionin parlamentar, duke mos pranuar argumentet e presidentit e rikaloi ligjin me disa ndryshime. Parashihej hapja e një konkursi. Megjithatë, ndonëse në fund janari, nga teatri dhe ligji për të nuk ka asnjë lajm. Prej muajit shkurt protesta e artistëve vazhdon dhe prej muajit qershor kanë kaluar më shumë se 200 ditë që protesta është e përditshme. Çdo mbremje një grup artistësh mbledhin mesë godinave të dy teatrove kombëtarë.

KOMPOZITORI

PËRCILLET PËR NË BANESËN E FUNDIT KOZMA LARA

Është ndarë nga jeta të premten në mbremje në moshën 87-vjeçare kompozitori i njohur Kozma Lara. Lajmi është bërë i ditur nga muzikologu Vaso Tole, që e cilëson Larën si një nga më të mëdhenjtë e muzikës shqipe. "Me dhimbje ndajmë në këtë orë të vonë, lajmin e ndarjes nga jeta të prof. Kozma Lara (1930-2019), i fundit nga të mëdhenjtë themelues të muzikës shqiptare. Homazhet në nderim të Tij do të mbahen nesër në hollin e Universitetit të Arteve, ditën e shtunë, datë 19 janar 2019, nga ora 11.00-12.00. I paharruar do të mbetesh profesori ynë!", shprehej Tole. Ndërkohë, gjatë ditës së shtunë, Lara është përcjellë për në banesën e fundit. Në intervistën e tij të fundit dhënë për "Abc News" pas një aktiviteti të mbajtur nga Akademia e Shkencave dhe Universiteti i Arteve më 14 dhjetor 2018, Lara ka thënë se aroma e detit ka qenë një frymëzim i pashtershëm për të. Profe-



sor Kozma Larën që shprehur se ajo që e gëzonte më fort ishte liria. "E kam sfiduar edhe diktaturën e kornizave në këtë formë. E ndjej veten me fat që një pjesë të krijimtarisë e ndjek edhe brezi i ri". Kozma Lara është autor i shumë krijimeve muzikore: kuartete, trio, romanca, rapsodi etj., si dhe ka krijuar shumë këngë për fëmijë. Ka qenë President i Shoqatës muzikore "Tonin Harapi", i festivalit të përvitshëm të Romancës Shqiptare dhe anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve, Artistëve dhe Kompozitorëve të Shqipërisë.

SHFAQET "MBRETËRESHA E BUKURISË E LINEJNIT"

Javën e ardhshme shfaqet në teatër më 26 dhe 27 janar premiera "Mbretëresha e Bukurisë" e autorit Martin McDonagh. Vepra është prodhimi i Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", salla "Moliere" ora 19:00. Pjesa e përkthyer nga Adriana Tolka, me regji të Kiço Londo, skenografi të Beqo Nanaq dhe kostumografe Sofi Kara, vjen me interpretimin e aktorëve Laura Nezha, Ermira Gjata, Genci Fuga, Engjell Hoxha. As/regjisor: Marsel Greva, Kleard Gërmenji.

"Mbretëresha e bukur e Linejnit" është një komedi e shkruar nga autori Martin McDonagh, e cila u ngjit në skenë për herë të parë nga kompania e Druid Theatre në Galluej, Irlandë, më 1 shkurt 1996. Ajo gjithashtu shijoi suksesin e shfaqjeve në "Uest End" të Londrës, Broduej dhe Of-Broduej. Është kandidat për çmimin Lorenc Olivier si vepra më e mirë dramatike për prodhuesin e Londrës, dhe produksio-



ni i Broduejtit i vitit 1998 u kandidua për 6 çmime "Toni", duke fituar 4. Kjo komedi tragjike vazhdon të shfaqet me sukses në skenat botërore. Vepra, e vendosur në malet e Konemaris në kontenë Galluej të Irlandës, rrëfen historinë me nota të errëta komike të Morin Folanit, një grua e zakonshme dhe e vetmuar në të dyzetat, dhe të nënës së saj manipuluese Meg. Ndërhryja e Megit në mundësinë e parë dhe ndoshta të fundit të së bijës për një lidhje

dashurie vë në lëvizje një tren me ngjarje sa komike, aq tmeruese, të cilat çojnë në fundin e pashmangshëm tragjik të pjesës. "Mbretëresha e bukur e Linejnit" është një kritikë ndaj nacionalizmit irlandez, i cili është toksik dhe antimodern, ndërkohë që tregon nevojën urgjente për një identitet, që nuk është vetëm modern, por edhe irlandez. Ndërsa prioritetet e autorit Mckdonah sillen te krijimi i komedisë së zezë, fakti që vepra është bërë kaq e famshme tregon vendin voluminoz, që së ajo në një diskutim më të gjerë mbi luftën për të gjetur një truall të mesëm midis nacionalizmit, që qëndron larg realitetit, dhe modernitetit të zbrabzët kulturialisht. Ndërsa Mckdonah nuk e drejton gishtin mbi ndonjë lloj shprehe apo zgjidhjeje në vepër, cikli zemërtshyes i traumës mes personazheve në Linejn paraqet një kritikë kulturele të rëndë dhe të sinqertë.

E DIEL

20 Janar

2019



NGA ALBERT P. NIKOLLA

Botimi i fundit i I. Kadaresë “Kur sunduesit grinden” është një sprovë tejte interesante mbi dinamikat antropologjike të marrëdhënieve diktator – artist nën diktaturën komuniste. Shpesh diktatorët kanë pasur një marrëdhënie xhelozie me artistët. Shumë prej tyre, para se të merreshin me politikë e të bënin karrierë, janë marrë në mënyrë periferike me art. Stalini deri në moshën 17-vjeçare përqipje të shkruante poezi, më vonë truri iu rreshk prej pasionit orëzi kriminal. Edhe diktatori Hoxha në veprat e tij dëshmon njëfarë pasioni për artin duke iu referuar shkrimtarëve dhe poetëve botërorë e duke ushtruar mediokritetin artizanar prej tregimtari në librin “Vitet e vegjëlisë”! Është tashmë e qartë, pas botimeve të shumë arkivave, se E. Hoxha ndaj Kadaresë ka pasur një ndjesi të dyfishtë: zili dhe një ndjesi tjetër të papërcaktuar artë e cila vërtitej diku midis urrejtjes dhe tërhuzjes. Po, edhe tërhuzje! E mendoj këtë sepse ashtu si dija, edhe arti i përsosur është pushtet dhe këtë pushtet të artit diktatura e kërkon medoemos në shërbim të saj, përndryshe i shkakton frikë për humbjen e pushtetit! Sidoqoftë Hoxha e ka pasur një zharg të padepërueshëm dhe vështirë të kuptohej lehtë se ç’mendonte! Botimi i ditarit sekret të E. Hoxhës me shënimet e tij për poezinë “Në mesditë Byroja Politike u mblodh” dëshmon edhe frikë ndaj Kadaresë.

“Ismail Kadaresë i është rritur mendja që botuesit borgjezë i shtypin disa romane, ai do të vazhdojë dhe përqipet të mbajë skemën e asaj bote, për sa i përket Shqipërisë Socialiste. Ai dëshiron të bëhet “shantri i saj”. (Ditari i E. Hoxhës. E hënë 20



Përballja e Kadaresë me Enver Hoxhën!

tetor 1975).

Ky, besoj, është thelbi i dëshirës së një diktatori për të telefonuar një artist të madh: kam frikë prej teje, por jam më i fortë e mund të të bëj keq. Ashtu siç unë kam frikë prej teje, po ashtu ti duhet të kesh frikë prej meje! Por ka një ndryshim të madh midis frikës së sun-

duetit politik dhe sunduesit artistik. Frika e diktatorit vjen nga brenda shpirtit të tij e për këtë arsye ai mund të jetë i rrezikshëm, pasi nuk e kontrollon dot frikën e tij. Ndërkohë frika e artistit është e jashtme dhe disi e menaxhueshme! Në fakt Kadareja bën autokritikë pas sulmit që i bëhet

prej partisë me rastin e shkrimit të poezisë “Në mesditë Byroja Politike u mblodh”. Megjithëse sulmi ndaj tij ishte i frikshëm, sërisht Kadareja nuk e percepton mirë rrezikun e madh dhe menjëherë pas kritikës fillon bocat e para të “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave”! Me sa duket ai nuk mëson as nga dija osmane

që i kishte treguar prof. Çabej: “Kishte qenë profesor. Çabej që gjatë udhëtimit tonë në Stamboll, më kishte shpjeguar kuptimin e emërimit të saj në osmanisht: «Ibret Tashë». «Mëso nga pësimi»”. (Kur sunduesit grinden. Kadare f. 27)

→Vijon në faqen 14

Në këtë numër: FAN NOLI, ALBERT P. NIKOLLA, FERIDE PAPPLEKA, KRENAR ZEJNO ETJ...

A

ARGUMENT

NGA ALBERT P. NIKOLLA

Vijon nga faqja 13

Dhe në fakt bash kulmin e shprehjeve të disidencës së tij e shënnon me këtë roman e sido mos me një pasazh që veç një Zot e di se si i ka shpëtuar syrit vigjilent të simahorëve redaktorë. Te ky pasazh del krejt ashiqare se autori i referohet diktatorit Hoxha dhe qeverisë komuniste. Ku e ka marrë këtë guxim Kadareja? Një ndër shpjegimet mund të jetë se ky guxim ka të bëjë me pasionin sublim, gati të pavetëdijshëm, të artistit të vërtetë. Arti e tërheq magjishëm drejt një "heroizmi artistik" dhe në atë pasion frymëzimi as vdekja nuk të shkakton më frikë.

"Ne Qyprilljintë jemi si ata njerëzit që kanë çelur toka e jetojnë në këmbët e vullkanit Vezuv, - thoshte gjysmë me të qeshur daja i vogël Kurt Qyprilliu. Ashtu si Vezuvi që shpërthen herë-herë e djeg e shkrumbon ata që jetojnë në hijen e tij, ashtu na godet edhe ne herë pas here sovranit, nën hijen e të cilit rrojmë. Dhe ashtu si ata që jetojnë në këmbët e Vezuvit, me gjithë fatkeqësitë e herëpashershme të tij, pas qetësimi të vullkanit, prapë aty, në tokat pjellore, te këmbët e tij ngrenë jetën, ashtu edhe ne, me gjithë rrebeshet që na dërgon sovranit, prapë nën hijen e tij qëndrojmë dhe i shërbejmë besnikërisht!" (Kadare. Nëpunësi i pallatit të ëndrrave.)

Kadareja jep një shpjegim në libër për lidhjen ndërmjet përsosjes në art dhe vdekjes. Aty shpreh gati-gati një dehe dhe një shprehje prej fatlumi sikur vdekja të vinte si pasojë e përsosjes. Paradoxshisht, sipas tij, pa vdekje nuk kishte as përsosje! Ja që arti nuk ishte i lehtë dhe dikë që mund ta bënin të gjithë! Në këtë vështrim kuptohet kapërthimi i artistit Kadare në realitetin shqiptar.

"E ndjeja atë lodhje mortale që po më kaponte prapë risjellja ndër mend e epilogut të librit, në vend që të më jepte një shkas më tepër për ta pezulluar, më bëri të mendoja se po të ishte puna për t'u përsosur, pra për ta pësuar, do të ishte me të vërtetë një fat që ta pësua nga kjo mrekulli. ... A! Epilog i kishte të dyja, përsosjen dhe vdekjen, ngaqë një fat i tillë e kushtëzonte herë pas here artin: s'mund të ishte i përsosur pa qenë i mbaruar." (Kur sunduesit grinden, Kadare, f. 43)

Besoj se vepra e Kadaresë ka elemente mjaft interesante disidencë "sui generis"! Nuk është një disidencë që shfaqet në formën e poezisë së Mandeshtamit, por e një lloji tjetër, me mjaft shpiti e metafora. Sa herë kam menduar për dallimin ndërmjet disidencës "sui generis" të Kadaresë dhe disidencës së fortë të shkrimtarëve sovjetikë më ka ardhur në mendje një pasazh nga "Njeriu në revoltë" i A. Kamysë. Kur Kamy shkruan për romanin "Ditari i Siberisë" të shkrimtarit E. Dëinger, jep disa detaje interesante për një personazh të këtij libri: një nëntënt gjerman i cili ishte i burgosur në një gulag të tmerrshëm ku mbretëronte të ftohtit dhe uria. Ajo çka e bënte tejet të veçantë këtë personazh lidhej me faktin se, ngaqë ishte muzikant, kishte ndërtuar një tastierë pianoje të heshtur me ashka druri. Me atë tastierë ai kompozonte muzikë që vetëm perceptohej nga autori

"Ismail Kadaresë i është rritur mendja që botuesit borgjezë i shtypin disa romane, ai do të vazhdojë dhe përpigjet të mbajë skemën e asaj bote, për sa i përket Shqipërisë Socialiste. Ai dëshiron të bëhet "shantri i saj". (Ditari i E. Hoxhës. E hënë 20 tetor 1975). Përgjigja e Kadaresë është e thjeshtë, shumë vite më pas: Ky, besoj, është thelbi i dëshirës së një diktatori për të telefonuar një artist të madh: kam frikë prej teje, por jam më i fortë e mund të të bëj keq. Ashtu siç unë kam frikë prej teje, po ashtu ti duhet të kesh frikë prej meje!...Pikërisht, këtë mëdysheje të madhe sqaron dhe autori ynë...

Artisti Kadare telefonohet nga artizanali Enver!

(Shkapetja mes artit, pushtetit dhe moralit të sprovat "Kur sunduesit grinden")



Kadare dhe Agolli mes kolegësh

e që natyrisht askush nuk arrinte ta dëgjonte, pasi ishte e patungull. Në të njëjtën mënyrë vepra e Kadaresë e ka një disidencë të heshtur, por të pranishme mes rreshtash.

Ndërkohë disidencën e poetëve sovjetikë është e fortë, e ashpër deri në sarkazëm të hapur ndaj dhunës së tmerrshme staliniste. Poezia e Madeshtamit "Stalinit" është shkaku themelor i telefonatës që Stalini i bëri Pastërnaku dhe përbën boshitën e librit "Kur sunduesit grinden"! Kishte rënë në duart e shërbimeve sekrete dhe kishte shkuar deri te Stalini. Pastërnaku i tronditur kishte kërkuar të ndërhynte kundër një dënimi të mundshëm të Mandelshatmit. Poezia është e nëntorit të vitit 1933.

"Stalinit!
Rrojme pa nuhatur vendin poshtë këmbëve tona,
bisedat tona nuk dëgjohej as dhjetë hapa tutje,
e në ka vend për një gjysmë bisede edhe aty ndërmendim malokun kaukazin.

Gishtat e tij shtypsa janë të majmura si krimba
dhe fjalët okë të rënda bartin të vërteta,
qeshin muestaqet prej brumbulli
dhe ndrisin kambalet e tij.

E përreth tij një zukanë shefash me qafë të hollë,
Përkënaqet me shërbime njerëzish gjysmakë,
Kush fërshëllen, kush mjaullin, kush hingëllin,

sapo ai hap gojën dhe ngre një gisht.
Si patkonj mbërthehen dekretet e tij,
Kujt në brinjë, kujt në ballë, kujt në vetull a sy.

Cdo vdekje për të është një trofe, dhe gjoksi i gjerë prej osetiani".

Telefonata e Stalinit është e kobshme. Pastërnaku tronditet pasi diktatori e këput bisedën në mes pas tre minutash. Biseda vër-

titet rreth Mandelshatmit. Pastërnaku e di mirë se Stalinit i ka rënë në dorë poezia e Mandelshatmit. Asokohe Pastërnaku jetonte në një apartament të përbashkët. Fenomeni tipik në qytetet komuniste sovjetike, por edhe në Shqipëri. Edhe vetë kam jetuar dy vite, përgjatë komunizmit, në apartament të përbashkët dhe e përfytyroj shumë mirë sa të huaja janë ato baneza për delikatesën njerëzore, për privatesinë dhe tekefundit për vetë dinjitetin njerëzor. Përveç faktit se ajo telefonatë me siguri regjistrohej nga shërbimet sekrete, prapë sytë roja të banorëve të apartamentit do të vëzhgonin shprehjet e fytyrës së Pastërnaku gjatë bisedës. U zverdh, u skuq apo thjesht nuk i ndërroi ngjyra e fy-



tyrës!
"Borisi, me sa duket, u tremb, dhe u përgjigj: "Unë pak e njoh atë. Ai është akmeist, kurse unë i përkas një rryme tjetër. Kështu që asgjë s'mund të them për Mandelshatmin."

"Kurse unë mund të them se ju jeni një shok shumë i keq, shoku Paster-

nak", - tha Stalini dhe mbylli telefonin." (Kur sunduesit grinden, Kadare, f. 61)

Një telefonatë do të ndodhte edhe mes diktatorit Hoxha dhe Kadaresë, por jo për të njëjtën arsye. Diktatori tonë i ka pëlqyer një poemë e sapobotuar e Kadaresë. Një telefonatë e një niveli të tillë është njëllor durate e çmuar. Të paktën kështu mund të perceptohej nga të gjithë shkrimtarët dhe intelektualët. Antropologu francez M. Mos (Maus) në një ndër sprovat më të famshme antropologjike, "Sprovë mbi duratën", ka provuar se në dinamikat kulturore njerëzore durata nuk është kurrë e painterit! Edhe telefonata e Enverit është e tillë, kemi një telefonatë që vë përballë në një përplasje të çuditshme, jo më me shpata apo pushkë, por me fjalë nëpërmjet telefonit. Kundërsharët i flasin, por nuk e shikojnë shoqë-shoqin. Historia njihje mjaft raste dualesh shkrimtarësh për arsye nga më të ndryshmet. Pushkini kishte vdekur pas plagosjes në një duel me një francez të fisëm, Lermontovi ishte përballur në duel me Martinovini! Por në këtë rast artisti Kadare ka përballë një artizanali dhe diktator. Këtë herë përballja nuk bëhet me plagosje, por me lavdërimë dhe falënderime! Sunduesi politik, diktatori, e josh shkrimtarin nëpërmjet lavdeve, i transmeton mesazhin se të tilla poema si kjo e fundit duhet të shkruajë. Nëse poemat nuk janë të tilla, nuk ka më telefonata. Por nëse nuk ka më telefonata, pasi ka mbërritur e para, mund të presësh çdo lajm të kobshëm. Ndërkohë që sunduesi letrar përdor vetëm armën e vetëmbrojtjes: "falemnderit!"

"Jam Haxhi Kroj, - tha zëri. Me ju do të flasë shoku Enver. Nuk arrita të them asgjë përveç fjalës "falemnderit!" më përgëzoi për një poemë që sapo ishte botuar në gazetë. Unë i thashë prapë "falemnderit!" (Kur sunduesit grinden, Kadare, f. 11)

Ashtu si Mandelshatimit, të cilit iu ndalua për një periudhë kohe banimi në Moskë, edhe Kadareja u dërgua të provojë një internim "sui generis" nën pretekstin e "punës prodhuese të intelektualëve" sipas modelit kinez! Edhe Kadareja u detyrua për disa kohë të qëndronte larg Tiranës. Shkrimtarja Helena Kadare e ka përshkruar me mjaft emocion këtë periudhë në librin e saj "Kohë e pamjaftueshme"! Asokohe Kadareja pati shkruar një poezi për babanë e tij dhe mërzinë e tij mbi kritikën për poezitë e të birit! Mandeshtamit, kur iu ndalua e drejta e banimit në Moskë, pat shkruar vargun e famshëm: "No ljublu etu kurvu Moskvu" (Ja që e dua këtë kurvë Moskë)

Debatet mbi politizimin e artit dhe marrëdhënien e shkrimtarit me pushtetin janë të pafundme. Shpesh në këto debate ka dalë në pah kundërthënia nëse është i mundur arti i vërtetë nën një diktaturë pa qenë mirëfilli disident. Sipas një pjese të studiuësve, një art i vërtetë është i pamundur në diktaturë përveç në rastet kur është qartazi disident. Ndërkohë që studiuesi B. Groys

pohon se arti i vërtetë është i mundur edhe nën diktaturë, e madje edhe kur nuk është qartësisht disident me regjimin.

Në këtë plan arsyetimi, autori B. Groys në librin e tij "The total art of Stalinism" shtron një pyetje mjaft të rëndësishme mbi ekzistencën ose jo të artit të mirëfilltë në komunizëm. Ai pohon se megjithëse është e vështirë të krijohet art i vërtetë nën diktaturë, pasi arti në vetvete parakupton të qenët i lirë e të krijuarit në liri, përsëri arti shpërthen edhe nën tryzni. Më tej autori nxjerr një përfundim mjaft interesant: as diktatura nuk mundet ta përdorë artin si të tillë, kur ky është i vërtetë, por vetëm disa aspekte të veprimtarisë artistike. Kjo është arsyeja se pse kishim art të vërtetë në komunizëm. Keqpërdorimi i artit në socializëm zë fill, sipas këtij autori, nga "dëshira e artit" për t'u keqpërdorur dhe modeli frymëzues është ai i "Pararajës artistike" krijuar në Bashkimin Sovjetik pas Revolucionit të vitit 1917. Ky model, me përfaqësues kryesor A. M. Rodçenko, shpallte vdekjen e artit "të muzeve" dhe lindjen e "artit të vërtetë" që ndërton botën e re. Është ky model artit që flirton me pushtetin dhe që bëhet i

Analiza e rezultati të këtij pohimi të Kamyse na bën të besojmë, pa cimatje, se Kadarenë nuk e zuri demokracia pa artin e tij. A kishte prodhuar Kadareja një art të vërtetë në komunizëm dhe a e gjeti rënia e komunizmit me artin e tij? Nuk kam asnjë dyshim se Kadareja prodhoi një art të jashtëzakonshëm në komunizëm dhe ai art mbe-

Vepra e Kadaresë ka elemente disidence

Besoj se vepra e Kadaresë ka elemente mjaft interesante disidence "sui generis"! Nuk është një disidence që shfaqet në formën e poezisë së Mandesh-tamit, por e një lloji tjetër, me mjaft shpoti e metafora. Sa herë kam menduar për dallimin ndërmjet disidencës "sui generis" të Kadaresë dhe disidencës së fortë të shkrimtarëve sovjetikë më ka ardhur në mendje një pasazh nga "Njeriu në revoltë" i A. Kamyse.

"vrasjes së ndërgjegjes" dhe lidhjes së tij me ideologjinë marksiste. Fragmenti ku shkruan për këtë argument përbën një ndër kulmet e këtij libri.

"Komunistët i trembte arti ... Nga një shfletim i Karl Marksit nuk ishte vështirë të kuptohej që njeriu që ia kishte kushtuar jetën e vet përmbyesjes me dhunë të rendit botëror, në dhjetëra libra e tij nuk kishte asnjë gjysmë faqe për tronditjen dhe pendimin që shkakton dërdhja e gjakut njerëzor: Mund të thuhej se Karl Marks i propozoi njerëzimit kasaphanën e madhe, por pa e shoqëruar, së paku, me porosinë e thjeshtë njerëzore: megjithatë, kujdes nga vrasja e ndërgjegjes." (Kur sunduesit grinden, Kadare, f. 61)

Fenomeni i pendesës është thellësisht i krishterë dhe si i tillë ishte i përjashtuar nga një ideologji e cila armikun më të madh kishte shpallur Kishën Katolike! Zgjon kureshtje fakti që Papa përmendet si armiku i parë i "fantazmës komuniste" në Manifestin e Partisë Komuniste dhe bash në fjalinë e dytë të këtij dokumenti: "Një fantazmë sillte nëpër Evropë - fantazma e komunizmit. Të gjitha forcat e Evropës plakë, Papa dhe Cari, Meternihu dhe Gizo, radikalët francezë dhe policët gjermanë janë bashkuar për t'i bërë luftën e shenjtë kësaj fantazme." Pendesa përveçse ishte e papërputhshme me marksizmin në pikëvështrimin ideologjik, ajo ishte po aq e dëmshme në ndërtimin e socializmit. Ky i fundit kishte nevojë për njerëz të vendosur për çdo krim që mund t'i thërriste komunizmit. Një i penduar ishte e padenjë për komunizmin. Edhe Pastërnaku, personazhi kryesor i librit, sipas mjaft studiuesve ka pasur një konvertim nga hebraizmi në krishterim. Studiuja Olga Frejdenberg ka përuar se atmosfera e romanit "Doktor Zhivago" është thellësisht e krishterë!

Fakti që Kadareja i mëshon pa pre konceptit të pendesës qoftë në këtë libër, qoftë në esenë "Ndërgjegjja e gjymtuar e shqiptarëve" ku shpjegimi është më organik, dëshmon se në ndryshim nga mjaft artistë të tjerë të gjamës së komunizmit, ai ka një largësi të mjaftueshme mosndotjeje nga krimet dhe kriminelët e komunizmit. Ky fakt dëshmon veç të tjerash se Kadareja nuk ishte i preferuari i regjimit, siç mundohet ta paraqesin disa rrimohues. Në analizën që

këshortët e tyre, dëgjonin radio të huaja, pin-inkool, urionin pemën e miqësisë shqiptar-sovjetike të mbjellë nga Hrushovi, shihnin filxhanin, dëgjonin radiot e huaja! Të gjitha këto bënin që Kadareja të ishte një tip shkrimtari që nuk mund të ishte model frymëzues për rrethin e letrarëve të rinj apo për "njerëzit e rinj", por paradoksalisht për kritikët e artit socialist kishte mjaft talent. Ashu siç kishte një kundërtënie themelore midis predikimit dhe praktikës komuniste, që studiuesja Evgenija Ginsburg e kishte quajtur "udhëtim me marramendje", po ashu kishte një kundërtënie mes talentit të Kadaresë dhe produktit të tij letrar jo shumë "socialist"! Ky fakt krijonte hutim jo të vogël te kritikët dhe pushtetarët e regjimit.

Një tjetër element antropologjik i rëndësishëm që del nga libri i fundit i Kadaresë ka të bëjë me përdorimin e fjalës "zonjushë" gjatë komunizmit! Fjalët "zotëri", "zonjë", "zonjushë" ishin të papërputhshme me ideologjinë komuniste dhe ishin zëvendësuar dhunshëm me fjalët "shok" dhe "shoqe"! Por, çuditërisht, siç vëren Kadareja, fjala "zonjushë" i kishte rezistuar sidomos te nxënësit e shkollave të vetëgjyeshme dhe të mesme!

"Kurse befasimin më të bukur do ta shkaktonte fjala e tretë "zonjushë". Zëvendësimi i saj ishte kërkuar me këmbëngulje, ngaqë ishte më e afërta me morfemën "nënë", sidomos në shkollat fillore. Me gjithë nervozizmin që shkaktonte, ngaqë përdorej nga dhjetëra mijëra fëmijë të mitur, në vend të fjalës "mësuese". Përpjekjet për ta zëvendësuar kishin dështuar njëra pas tjetrës. Fëmijët e vegjël me kokëfortësi vazhdonin t'i quanin mësueset e tyre "zonjushë". Dhe ishte pikërisht kjo armatë e pafundme e kalama-je që u tregua e pathyeshme gjersa fjala me hijeshi tronditëse "zonjushë", zuri vend përfundimisht në gjuhën shqipe." (Kur sunduesit grinden, Kadare, f. 82)

Kujtoj kohën e gjimnazit kur përdorimi i fjalës "zyshë", shkurtim i fjalës "zonjushë", ishte tashmë i pranuar nga të gjithë profesorët, madje edhe nga ata që ishin anëtarë partie. Ishte si ngjashmëria me "muzikën pa tingull" që përmenda më lart ose si disidencia e Kadaresë, e cila ishte aty mes librave dhe ndërgjegjja jonë kolektive e kishte pranuar si të mirëqenë dhe të parrezikshme! Një lloj bashkëjetese me armikun, por që nuk e trazonte shumë sundimtarin! Kështu që sundim-



padëshruar kur pushteti bie. Në Shqipëri ka pasur një model të tillë, por në këtë model nuk përfshihet arti i Kadaresë.

Groys pohon se arti e ka në natyrën e vet politizimin. Gjithë arti i mesjetës ka qenë i lidhur me një mijë fije me pushtetin. Por konflikti i njerëzve me artin - sipas tij - është i dyfishtë, sepse arti jo vetëm i shërben pushtetit e diktaturës, por edhe për vetë natyrën e tij arti krijon një lloj diktature estetike që disa njerëz nuk e pëlqejnë. Një krahasim interesant në këtë kontekst mund të ishte edhe pohimi i Kadaresë në parathënie e botimit të veprës së plotë të Martin Camajit në të cilin thotë se arti është një ndërtesë hijerëndë ku nuk mund të hyjë kushdo! Përgjatë analizës së artit të asaj kohe, më shumë sesa politizimi, që ishte si "paketim i domosdoshëm" i artit nën diktaturë, mund të shihet paraqitja artistike e artistëve të talentuar shqiptarë që dhuruan kënaqësi estetike edhe atëherë kur dhuna ishte mbytëse në çdo skutë të jetës. Në mos për artin, për sakrificat e panumërta njerëzore duhet të kemi respekt.

Art të vërtetë ka pasur në kompozim dhe interpretim të këngëve, në pikturë e në letërsi. Po ashtu ka pasur edhe keqpërdorim të artit të vërtetë dhe të pseudoartit. Diferenca midis artit të vërtetë dhe pseudoartit, në kuptimin e përdorimit politik, qëndron në faktin se arti i vërtetë mund të keqpërdoret nga politikanët, ndërkohë që pseudoarti ofrohet vetë për keqpërdorim. Është si të thuash "art prostitucioni". Ndër gjithë gjykimet që kam lexuar mbi misionin e shkrimtarit në një shoqëri, ai i A. Kamyse më është dukur mjaft i ashpër.

"Misioni i shkrimtarit lidhet me detyra tepër të vështira; për vetë natyrën e tij arti nuk mund të vihet në shërbim të atyre që bëjnë historinë. Arti është në shërbim të atyre që e pësojnë historinë. Përndryshe shkrimtari mbetet pa artin e tij". (Fjalimet e Suedisë. A. Kamy. 1957)

tet i madh edhe pas rënies së komunizmit. Më kujtohet biseda më një piktor shqiptar i cili më pohonte se në vigjilje të një botimi me poezi të Kadaresë, diku rreth viteve '60, ishte zgjuar në orën pesë të mëngjesit për t'u vënë në radhë për ta blerë librin. Te libraria kishte vënë re se kishte mjekë, oficerë, punëtorë, inxhinierë! "Poezia e tij na jepte një sens lirie nën atë rrasë të madhe guri që ishte diktatura" - më tha me emocion të madh piktori! Po ashtu shkrimtarja V. Bekteshi ka përuar se kur ka qenë në internim ka shitur sende të saj vetjake për të blerë librat e Kadaresë, pasi ata e mbanin në gjallë.

Çdo artist, përveç marrëdhënies me të bukurën, ka edhe një marrëdhënie me ndërgjegjen e vet, dhe kësaj nuk i shpëton dot e në të nuk mund të hyjë askush veç moralit. Në librin e fundit Kadareja prek dhe këtë argument mjaft delikat dhe bën një vëzhgim antropologjik që rrallë e kam hasur për sa i përket fenomenit të

Pse Enveri e vinte në radhën e dytë Kadare, pas shkrimtarëve të tjerë

Fakti që Kadareja i mëshon pa pre konceptit të pendesës qoftë në këtë libër, qoftë në esenë "Ndërgjegjja e gjymtuar e shqiptarëve" ku shpjegimi është më organik, dëshmon se në ndryshim nga mjaft artistë të tjerë të gjamës së komunizmit, ai ka një largësi të mjaftueshme mosndotjeje nga krimet dhe kriminelët e komunizmit. Ky fakt dëshmon veç të tjerash se Kadareja nuk ishte i preferuari i regjimit, siç mundohet ta paraqesin disa rrimohues. Në analizën që u kam bërë veprave të E. Hoxhës mbi hapësirën që i kushton diktatori Kadaresë, kam vënë re se ai nuk dëshmon një vlerësim të madh për Kadarenë. Ai është përherë në plan të dytë pas Agollit, Spases, Gjatës dhe Xoxes.

u kam bërë veprave të E. Hoxhës mbi hapësirën që i kushton diktatori Kadaresë, kam vënë re se ai nuk dëshmon një vlerësim të madh për Kadarenë. Ai është përherë në plan të dytë pas Agollit, Spases, Gjatës dhe Xoxes. Për Hoxhën, Kadareja nuk ishte një Shollovoh i denjë për Shqipërinë. Një Shollovoh dinjitoz duhej të ishte një shkrimtar që vishej si fshatar dhe që fotografohej përherë mes tyre. Përkundrazi, Kadareja kishte pamje prej borgjezi me syze të errëta dhe askund nuk e gjeje duke bërë foto me mjelëse të dalluara, siç mund të gjeje mjaft shkrimtarë të tjerë.

"Shollohovi, pavarësisht se ç'tip ishte dhe ç'tjetër bënte, nisi të paraqitej gjithkund si modeli i "shkrimtarit sovjetik", larg çdo trazimi të dyshimit, të vetmisht, të pijes, grave, gjithmonë buzagaz, fotografuar hareshëm midis fshatarëve të tij të Donit, shpesh me këmishë kolkoziane". (Kur sunduesit grinden, Kadare, f. 76)

Jo vetëm paraqitja dhe mungesa e fotove me kooperativistë, por edhe romanet e Kadaresë nuk kishin personazhe të stilit të Shollohovit, të cilët dashuronin me shumë partinë se gruan, personazhe që jepnin jetën për socializmin apo vrisnin njerëz që ishin kundër socializmit. Përkundrazi, personazhet e tij shpeshherë tradhtonin bash-

tari politik ia linte edhe sundimtarit artist pushtetin e tij, por me kushtin që të mos e tejkalonte kufirin e bibliotekave. E beftë ishte kjo dukuri por të përpiqemi t'i shohim shfaqjet e asaj kohe me syrin e një personi që e ka jetuar atë periudhë. Por befasia, sipas Kadaresë ka qenë një ndër veçoritë e regjimit komunist: tipari kryesor i enigmave të komunizmit ishte pikërisht shfaqja e tyre aty ku s'priteshin. (f. 145). Siç ishte i paparashikueshëm shpërthimi i Vezuvit, po aq vrik dhe i paparashikueshëm vinte edhe reagimi i sundimtarit politik! Ndoshte atëherë kur nuk ta priste mendjeja. Sunduesit artist dhe popullit nuk i mbetej gjë tjetër veçse të priste shpërthimin e llavës së nxehtë të sunduesit politik, ka kërkuar arsyeën "pse"! Në lidhje me kërkimin e arsyes dhe bërjen e pyetjes "pse" përballë absurdit të regjimit komunist, bashkëshortja e Mandelshtamit, Nadjezhda, në librin e saj "Epoka dhe ujërit" shkruan: "E kanë arrestuar? Pse e kanë arrestuar? Kjo pyetje ishte bërë për ne e palejueshme. Si pse? Është momenti të kuptojmë se nuk ka një pse! Edhe disidencia e Kadaresë është e veçantë dhe çdo pyetje rreth saj nuk mund ta rishfaqë të plotë misterin e artit të tij, sepse siç thoshte Balzaku "Gjeniu u ngjan të gjithëve, por askush nuk është i ngjashëm me të!"



E
ESEJA

Në nderim të një përvjetori të Fan Nolit, shkrimtarja e njohur Meri Lalaj na sjell një përkthim nga një prej studimeve të tij...

Parullat revolucionare

NGA FAN NOLI

Shindleri na tregon se "në ndjenjat e tij politike, Betoveni ishte republikan".¹ Ai e përsërit këtë pohim në të tre botimet e Biografisë së tij dhe kësaj here nuk ngatërrohet. Ka shumë të dhëna në letrat e Betovenit që e provojnë këtë gjë dhe se Shindleri thotë të vërtetën. Të gjitha parullat e Revolucionit Frëng gjenden në shkrimet e tij dhe ndonjëherë atje ku nuk ta pret mendja, në letrat e punës dhe në letrat e dashurisë. Veç duhet mbajtur mirë ndër mend se këto parulla ishin të ndaluara nga regjimi i vjetër i Vjenës, i cili i konsideronte të rrezikshme për shtetin dhe i ndalonte qytetarët e vet që t'i përdornin.

Në një letër drejtuar një botuesi të panjohur Betoveni flet për ideologjinë e vet republikane dhe për të drejtat e njeriut, të cilat janë nëpërkëmbur nga sunduesit.² Ai është demokrat dhe proteston kundër titullit aristokratik "kavaliër", me të cilin e quan Simroku dhe pyet me indignatë: "Përse mund ta meritoj? Pfu! Kush do ta pranonte një titull të tillë në këto kohëra demokratike?" Ai beson³ se pikërisht ashtu sikurse shteti duhet që të ketë një kushtetutë, ashtu duhet të ketë edhe kushtetuta individuale për secilin, me këtë kupton sërish të drejtat e njeriut dhe të qytetarit.⁴ Ai është "mik i të gjithë racës njerëzore"⁵ dhe kjo tingëllon si nga goja e Anacharsis Klocit. Ai kërkon ta rritë të nipin si qytetar-botëror⁶ dhe kjo do të thotë se ai beson në një republikë-botërore sikurse Kantit. Për më tepër, ai mendon se duhet të ketë vetëm një Kryesi të Artit në botë, së cilës artisti duhet t'i dorëzojë punën e vet dhe të marrë atë që i takon, kjo gjë tingëllon si socializëm.⁷

Sidoqoftë, ai nuk e pranon monarkinë në asnjë formë. Për të "mbretëria e diturisë është e dashura dhe më e larta nga të gjitha monarkitë, si ato të kishës dhe ato shtetërore".⁸ Kjo do të thotë të vendosësh epërsinë e Arsyes mbi çdo gjë, përbmi papët dhe peshkopët, mbi mbretërit, princërit dhe aristokratët, kështu kthehemi rishtas tek Revolucionin Frëng. Po, ai e do Lirinë mbi gjithçka.⁹ Ai e nderon Lirinë e të gjithë popullit.¹⁰ Liri!!! Ç'të duam më tepër???¹¹ Paqja dhe liria janë pasuritë më të çmuara.¹² Vetëm liria dhe përparimi janë qëllimi ynë në botën e artit dhe në krijimtarinë e tërësishme.¹³ Dhe në qoftë se nuk i kemi në Evropë, do shkujmë t'i gjejmë në Amerikë. Lavdi Zotit, tani kemi vaponët me avull. Në ato vende të largëta do të gjejmë ajër dhe Liri.¹⁴ Dhe në një letër të Dashurisë së Pavdekshme, Betoveni hap një paragraf në mënyrë që të futë këtë fjalë: "Nënshtrimi i njeriut tek njeriu më ngre nervat."¹⁵ Kjo tingëllon si jehonë e thirrjes

së Kantit: "E tërë genia ime fërgëllon kur mendoj skllavërinë."¹⁶

"Fidelio" opera e vetme që kompozoi Betoveni, së pari ishte një Himn i Lirisë dhe vetëm rastësisht lirikë triumfi për dashurinë bashkëshortore. Florestani është martir i ideve të reja, i së Vërtetës të re:

Wahrheit wagt' ich Kühn zu sagen
Und die Ketten sind mein Lohn!

(Unë guxova të them të Vërtetën
Dhe zinxhirët janë shpërblimi im!)

Të burgosurit, të lejuar për herë të parë për të marrë pak ajër të pastër, i këndojnë Himn Lirisë:

O Himmel! Rettung! Welch' ein Glück!
O Freiheit! O Freiheit! Kehrst du zurück!

(O Qiell! Shpëtim! Çfarë Lumturi!
O liri! O liri! Kthehesh prapë!)

Kur Florestani shikon Leonorën, mendon se ajo është Engjëlli i Lirisë:

Ein Engel, Lenoren, der Gattin so gleich,
Der führt mich zur Freiheit, ins himmlische Reich!

(O engjëlli, Leonorë bashkëshorte menjëherë,
Ajo më shpie mua në gëzimin e mbretërisë qiellore!)

Fernandoja, i lajmëruar nga trumbetat, është Çlirimtari. Ai nuk i lejon të burgosurit që të gjunjëzohen para tij, ai është miku i tyre, vëllai i tyre:

Nicht knien länger sklavish!
Tyrannenstrenge sei mir fern.
Es sucht der Brüder seine Brüder
Und kann er helfen, hilft er gern.

(Të mos jemi më skllavër!
Tutje rreptësia e tiranëve.
Vëllai kërkon vëllezërit
Dhe në qoftë se mund të ndihmojë e bën me qejf.)

Në Simfoninë e Nëntë gjejmë një Himn të Vëllazërimit Botëror. Në original Kënga e Gëzimit ka qenë Kënga e Lirisë¹⁷ dhe Betoveni pat filluar të punonte për këtë këngë që në vitin 1793. Kur Shileri e ndryshoi në Himn Gëzimit, vëllazërimit të Racës Njerëzore, u bë tema kryesore e vargjeve të famshme:

Alle Menschen werden Brüder...
Seid umschlungen Millionen
Diesem Kuss der ganzen Welt!

Të gjithë njerëzit bëhen vëllezër...

Të jesh i përqafuar prej milion-

ave
Me një puthje përqafim!

Betoveni merakosej që mesazhin e tij ta bënte përsosurisht të qartë kësaj here dhe, porsi pasardhësi i tij i madh Wagneri, u vuri tituj temave muzikore. Kjo ishte absolutisht e domosdoshme. Ai donte të afrohej me masat dhe t'u shpaloste atyre idetë e reja të Revolucionit Frëng me një gjuhë që ato ta kuptonin dhe ta admironin, me gjuhën e Shilerit, poetit të Kontratës së Re të Rusoit. Revolucionar në pikëpamjet e tij politike,

austriaku të ketë birrë të zeze për të pirë dhe salsicë për të ngrënë as që ia fillon revolucionit.¹⁸ Është e vërtetë se masat austriake ishin të qullëta, por mjeshtri me to kaq mund të bënte. U mundua shumë me njerëzit e mëdhenj, por ata i dolën më keq se mizëria. Medet! "Nuk ka gjë më të vogël sesa të mëdhenjtë!"¹⁹ Apo, siç e thotë Betoveni në frëngjisht: "Parceque les grands sont le plus faibles." (Sepse të mëdhenjtë janë më të dobët!),²⁰ kështu nuk mbetet gjë tjetër veçse të ngriheshin masat. Pikërisht kjo i duhej kohës së tij. Ai e shprehu

e Marie Antonetës dhe Luigjit XVI: Sic semper tyrannis! (Ashtu si gjithmonë tiranëve!) Po, vritini të gjithë, varini të gjithë mbretërit, princat dhe aristokratët.

Ah! Ça ira, ça ira, ça ira!
Les aristocrat' à la lanterne:
Ah! Ça ira, ça ira, ça ira!
Les aristocrat' on les pendra.

Ah! Do kalojë, do kalojë, do kalojë!

Aristokratët të shtyll' e fenerit;

Ah! Do kalojë, do kalojë, do kalojë!

Aristokratët do t'i varin.

Më kot sopranot e shkreta i luteshin mjeshtrit që të ndryshonte ato nota të larta të pamundura për t'i arritur. Betoveni ngulmoi në të tijnë. Ato thanë se do të tingëllonte e egër. Por ai pikërisht këtë donte, sepse vetëm atëherë masat do të mund ta kuptonin idenë e saj. Dhe ai pati të drejtë. Më 7 maj 1824 u dha shfaqja e parë e Meshës Soleme në Re dhe Simfonia e Nëntë. Baron Zmeskilli vajti të dëgjonte Simfoninë, e cila kishte si nëntekst zhdukjen e klasës së tij, por çdo gjë që bënte mjeshtri ishte e mirë për të. Baroni urdhëroi shërbëtorët që ta shpinin në Teatrin Karntnertor të ulur në një karrocë-vig, sepse u ngrit i sëmure nga dysheku.²¹ Sukses ishte i mahnitshëm: përshëndetja e publikut ndaj shfaqjes pati një karakter kryengritës, kur doli Betoveni në skenë brohoritjet shoqëruar me duartrokitje u përsëritën pesë herë, ndërsa sipas etiketës së rreptë të qytetit, ishte zakoni të jepeshin tri përshëndetje vetëm kur hynte Familja Perandorake. Policia u detyrua të ndërhynte për t'u dhënë fund manifestimeve. Simfonia shkaktoi një entuziazëm të papërmbytur. Shumë vetë qanin. Betovenit pas koncertit i ra të fikët nga emocionet; e shpunë në shtëpinë e Shindlerit ku humbi në gjumë dhe mezi u përmend pas njëzet e katër orësh, me rroba në trup, pa ngrënë dhe pa pirë asgjë.²⁴ Po, kësaj here Betoveni u afrua me masat jo vetëm me ato të Vjenës, por me masat popullore të të gjithë botës edhe për të gjitha kohërat me Simfoninë Jakobine të Lirisë, Barazisë dhe Vëllazërimit. Disa kritikë thonë se muzika e Simfonisë së Nëntë nuk është aq e mirë sa ajo e Simfonisë së Tretë dhe të Pestë. Ndoshta. De gustibus non disputandum. (Shijet nuk diskutohen). Por, gjëja më e rëndësishme për Betovenin në këtë rast ishte kumti dhe ai diti t'jau shpërndante këtë kumt revolucionar masave në një gjuhë aq të qartë sa ishte e mundur në rrethanat e epokës së Meternikut. Teksti nuk do të mundte të fliste kurrë më shkoqur. Censura e Meternikut nuk do ta kishte lejuar. Betoveni ia përshkruan situatën shumë mirë poetit



Betoveni ishte revolucionar edhe në artin e vet. Ai futi muzikë korale dhe solo vokale në pjesën e fundit të Simfonisë të Nëntë. Po, e bëri këtë për masat e budallallepura, të cilat nuk do të mundnin ta kuptonin fjalimin e tij muzikor. Ai u foli masave me zhargonin e tyre! Mirë, po a ishte e mundur që t'i ngrinte këto masa vjeneze, të mefsh-ta, të përgjumura, të painteresuara? Oh, këto turma të mjera të Vjenës! "Verflucht, verdammst, vermaledeites, elendes, Wienerpack!"¹⁸ Ato nuk dinin të bënin gjë tjetër veçse të hanin salsicë dhe të pinin birrë të zeze. Dhe kur dikush e pyeti Betovenin nëse revolucionin mund të shpërthëjë në Vjenë, ai përgjigjet me tallje: "Gjersa

fare mirë këtë teksa i shkroi atij vagabondit të vogël Karlit: "Koha jonë kërkon shpirt të fuqishëm për të futur në veprim këto masa njerëzore, burracake, tradhtarë të fundërrinave."²² Karli i tij e kuptoi më së miri. Ai dinte greqisht.

Po, Betoveni e ndiente se ai ishte një nga ata shpirtë të fuqishëm, të cilët Fati ka paracaktuar për detyra herkuliane. Tani Fati i troket tek dera dhe e urdhëron që të përmbushë misionin e vet të shenjtë. Është gati për të marrë detyrën më të madhe të jetës së tij. Ai do t'i bëjë sopranot të bërtasin, të klithin, të çirren me triumf deri në kupë të qiellit, sikurse prostitutat e pazareve të Parisit kur panë se gjijtina këputi kokën

Kufner: "Fjalët janë të lidhura me zinxhirë, por lumturisht tingujt janë ende të lirë."²⁵ Dhe ai përdori tingujt muzikorë që të plotësonte tekstin poetik. Masat e pëlqyen dhe ende e pëlqejnë bashkimin e tij mjeshtëror dhe dramatik të poezisë me muzikën.

Shkëputur nga libri i Fan Nolli: "Betoven dhe Revolucioni Frëng"

Përkthyer nga anglishtja: Meri Lalaj

Shënime

1. "Beethoven war seinen politischen Gesinnungen nach ein Republikaner." Shindler, 1845, I, f. 56

2. "Wie die Gesetzbücher sogleich bei den Menschenrechten, welche die Vollzieher bei alledem mit Füßen treten, anfangen, so der Autor... (Unter uns gesagt, so republikanisch wir denken, so hat's auch sein Gutes um die oligarchische Aristokratie)... Letër një botuesi, 1882(?) Kastner-Kapp, f. 632

3. "Pfu! wer wurde in unseren demokratischen Zeiten noch so eine Sprache annehmen?" Letër Simrokut, 2 gusht 1794, Kastner-Kapp, f. 21.

4. "Wie der Staat eine Konstitution haben muss, so der einzelne Mensch für sich selber eine." Skizzenblätter, 1816, Kastner-Kap, f. 360.

5. "Freund des ganzen Menschengeschlechtes." Letër Zmeskallit, 1816, Kastner-Kapp, f. 395.

6. "Weltbürger" Letër Rios, 1 shkurt 1816, Kastner-Kapp f. 337.

7. "Es sollte nur ein Magazin der Kunst in der Welt sein, wo der Künstler seine Kuntswerke nur hinzugeben hätte um zu nehmen was er brauchte." Letër Hofmajsterit, 15 janar 1801, Kastner-Kapp, f. 37.

8. "Mir ist das geistige Reich des liebsten und die oberste allen geistlichen und weltlichen Monarchien." Letër Kankas, 1814, Kastner-Kapp f. 279.

9. "Freiheit über alles lieben!" Albumbblatt, 22 maj 1793.

10. "So wissen Sie wie ich die Freiheit aller Menschen ehre." Letër Amalie Sebaldit, 1812, Kastner-Kapp, f. 230.

11. "Freiheit!!!! Was will man mehr???" Letër Zmeskallit, 1814, f. 269.

12. "Ruhe und Freiheit sind die größten Güter." Skizzenblatt, 1817, f. 417.

13. "Allein Freiheit, Weitergehn in der Kunstwelt wie in der ganzen grossen Schöpfung, Zweck." Letër Rudolfit, 29 qershor 1819, Kastner-Kapp, f. 511.

14. "I mallkuar, i dënuar, i nëmur, popull maskara i Vjenës! Letër Bernardit, 15 shtator 1819, Kastner-Kapp f. 521.

15. "So lange der Oseterreicher noch braunes Bier und Würstel hat, revoltiert er nicht." Letër Simrokut, 2 gusht 1794, Kastner-Kap, f. 177.

16. "Etwas kleineres als unsere Grossen gibt's nicht." Letër Brajtkopfit dhe Hartelit, verë, 1810, Kastner-Kapp f. 177.

17. Letër Skotit, 22 janar 1825, Hull, f. 338.

18. "Unser Zeitalter bedarf kräftiger Geister, die diese kleinsüchtigen, heimtückischen, elenden Schufte von Menschenseelen geiseln." Letër Karl van Betovenit, 1825, Kastner-Kapp f. 785.

19. Thajer, botimi anglisht III, f. 165

20. Romen Rolan, Betoven, f. 46-47

21. Romen Rolan, Betoven, f. 49

R

REVIEW

Personazhe ireale bashkohen me ato realit dhe autorja në përgjithësi të vendos në një lloj letërsie që duket sikur e ka bërë Bulgakovi në ditët tona, ndërsa të fut në një botë tranzicioni ku lexuesi pret më kot që personazhet të shquhen, e materializmi të bëhet i prekshëm. Jo "tortura" që të jep ajo është e madhe dhe të mban deri në fund për të kuptuar se dashuria, ky element i bukur është kaq hyjnor dhe prodhon tek e fundit papritshmëri shumë të mëdha, të cilat nuk mund të skedulohen në forma dhe llogari...

"Tutori" i Mimoza Ahmetit, si Mjeshtri i Bulgakovit

NGA BEN ANDONI

Ndjesia e parë që një lexues i kualifikuar merr nga "Tutori", romani i fundit i Mimoza Ahmetit, është mbajtja e ritmit të narracionit. Dikush që do të testojë arritjen e autores, përpiqet të kapë më kot se kur do të bjerë regjistri i saj i rrefimit dhe do shtjellat me linja të zakonshme. Jo, ai nuk bie dhe lexuesi rrefimin fantastik të saj, pak si ngjashëm me "Mjeshtrin dhe Margaritën" e Bulgakovit, e merr deri në fund. Nëse nuk do kishte tek nuk ndoca gabime redaktimi atëherë rrjedha do ishte fare e bukur dhe e mrekulueshme qepur me këtë regjistër kaq artistik fikshëni. Në fakt edhe ashtu është.

Merita kryesore e Mimoza Ahmetit, në mendimin personal, është se me romanin e saj ka treguar se autori i letërsisë shqipe mund të përballet me sfida të formës dhe një nga vlerësimet për të duhet të shkojë pikërisht tek një fakt i thjeshtë: ajo sfidon vetë stilin dhe lojërat i bën me stilin e saj. Në këtë stad, një lexues respekton këtë element lojçak të saj për të parë dhe kuptuar se letërsia nuk ka vdekur dhe bashkë me të edhe autori.

Në manuale të psikologjisë, sociologjisë mund të gjejmë përgjigje për shumë stadi të qenies ose parastadi, por letërsia si dikur edhe sot bën që t'i paraprijë këtyre shkencave për të treguar se ka diçka ku ato nuk do futen dot kurrë: Esenca kimike që prodhojnë emocionet tona, nuk mund të shpjegohen përmes ideve të sociologjisë, psikologjisë e me radhë. Autorja, pikërisht gjendjet e ndryshme ku vendoset psika jonë, mundohet t'i bashkojë në rrefimin e saj fikshën për të dhuruar këtë gjë të veçantë të një hapësire, që ajo e krijon për të vendosur personazhet e saj dhe të na parashtrijë këtë lloj anti-rrefimi të saj.

Një element i habitshëm, që zakonisht nuk ndodh në letrat shqipe, është kohëzgjatja e mbajtjes së librit. Referuar autores ky libër ka filluar nga viti 1994 dhe mbaroi në vitin 2017,



Titulli: "Tutori"
Gjinia: Roman
Autori: Mimoza Ahmeti
Botues: MAPO
Faqe: 182
Çmimi: 1000 Lekë

saj dhe me këtë në kokë ti e kupton në një farë mase vetë gjykimin dhe perceptimin që autorja nuk ka frikë dhe e shpreh hapur sepse shpesh është dhe mbetet vetja. Ajo ka dhe mban raportin e duhur me ndjenjat, por kërkimi i gjatë në fushën e psikës, e ka bërë të kuptojë si duhet veten e vet, ashtu si duket se lehtësimin e saj nga humltimi i thellë në disa nga shkencat ku zbulohet Uni e ka vendosur në një paqësi për egon e saj, që tek e fundit është i mbushur me kërkim.

Narracioni i saj në këtë veper nuk është normal dhe i afrohet një anti-rrefimi, ku lexuesi e ka të vështirë të gjejë vektorin e logjikës normale në letërsinë, që bëhet rëndom tek ne. Autorja e sfidon me kënaqësi kohën, një nga elementët më të vështirë të shqyrtimit të një romani dhe kjo e bën fabulën e krijimit të vet të notojë në drejtime ku nuk shkohet aq lehtë; ndërsa është hapësira që zë më shumë vend, e ku autorja tenton që të ngërthejë hapur personazhet e saj për të na treguar se tek e fundit gjenia njerëzore e vërtetë në shumicën e rasteve është në një gjendje të tillë transi normal. Po a është normale kjo lloj forme?! Kur e merr në letërsi e kupton se është fare e logjikshme. (Milsoja)

por lexuesi zhvillimin e tij nuk e shikon me shumë diferenca, që do të thotë se autorja nuk ka punuar në formë piramidale, duke shtruar bazën dhe shtjelluar subjektin por ka ushtruar të gjithë upgrade që i ka bërë vetes ndër vite për të përshtatur si duhet romanin me lexuesin e sotëm. Do të ishte e këndshme, që dikush ta pyeste sesi ka nisur dhe si është përshtatur, por zakonisht kjo përgjigje e autores mund të kundrojë vetë sesi ajo i shtjellon personazhet e saj, që duken më shumë si punë në akurë. Për atë që ia del të bëjë perceptimin e duhur të personazhit irreal, problemi nuk është shkrimi por mbetet vëzhgimi, pasi ajo vetë duket e lodhur nga letërsia që mundohet të prodhojë kinse

letërsi, ku shkollat, format dhe përmbajtjet (jo rrallë kë) heqin mrekullinë e gjinisë, që i reziston këtij zhvillimi të jashtëzakonshëm të njerëzimit.

Personazhe ireale bashkohen me realit dhe autorja në përgjithësi të vendos në një lloj letërsie që duket sikur e ka bërë Bulgakovi në ditët tona, ndërsa të fut në një botë tranzicioni ku lexuesi pret më kot që personazhet të shquhen, e materializmi të bëhet i prekshëm. Jo "tortura" që të jep ajo është e madhe dhe të mban deri në fund për të kuptuar se dashuria, ky element i bukur është kaq hyjnor dhe prodhon tek e fundit papritshmëri shumë të mëdha, të cilat nuk mund të skedulohen në forma dhe asnjë llogari...
 Ka dimension metafizik vepra e

MEDIA

Tema mbi gazetarinë e sotme duhet të përfshijë edhe rrezikun e shuarjes së dallimit mes të shkruarës dhe të folurës. Që janë aq të ndryshme. Duke e vështruar dhe kryqëzuar shikimin me fjalët që shkruan, shkruesi e njëj dhe rrezikun e shndërrimit në gur të njëjës nga palët...

Dyshi hidhet nga shtata dhe gjen njëshin (nga masa e mediave, te media e masave)

Akti i parë

Qysh prej atij primordial adamik, kur Ai dhe Ajo vendosin vetëvrasjen e qashtërisë për një sfidë: të kapërdijnë një kafshatë të ndaluar, mbase nën kureshtjen për të kuptuar mes brenide edhe ç'është dija e pushtetit mbi ta. Nga ky ballkon i vërvitjes për në dheun poshtë, parakalohjën pamje të artit, nga Shekspiri i tragjediës romantike të ballkonatës së vet, te Hygoi epik i të mjerëve të mizerjes e te Bodleri elegjiak i kryqit mes atij spleen si gjendje e trishtimit brengosës dhe mërziisë bodleriane që edhe i lypset njeriut për të ndriçuar njohjen e njerëzores, e gjjer dhe absurdi beketian i personazhit në çift pleqsh të veprës me titull: Oh, këto ditë të bukura!

gjer dhe absurdi beketian i personazhit në çift pleqsh të veprës me titull: Oh, këto ditë të bukura!
E nëse rasti i kësi çasti nuk bart këtë ngarkesë, pra as absurdin vetë si finale dhe rrugëdalje interpretimi pa rrugëdalje, është pikërisht prej kësaj që akti bëhet merrues. Pa implikimin e dashurisë si shtysë e pakontrollohem moshe pasioni: akti tyre s'gjen alibi. Kësisoj, i mbetet veçse politikja e tij, përfaqë e tyrja është një vetvrasje jo individuale por *in-dividum*, e pandashme, e duetit që rri në bazë të jetës dhe mbërjes së shoqërisë. Që i dha të shtymen. Te libri "Sikurgenia" haset dhe një faqe kronike të cilën e di dhe vetë se është e dobët e ku kam rënë në dobësinë e hakmarrjes pa artin e duhur të përshkrimt të realitetit, më shumë si për inat e mëri e hasmëri ndaj realitetit mediatik të përshkrimt, të cilin u përpoqa më kot ta vizatoja me fjalë në formën e një vegje pune antike që druvarit dikur e përdorte edhe për të mundësuar lëndën për letërën e shkrimit, por zakonisht për dru zjarri apo si këtu nën funksionin tjetër dytësor të zakoneve të të fortit për motive të dobëta:

Kur genia e dobët po i çan kokenë një genieje të fortë atëherë kjo genie e sertë dhe sipas dialektit të vet ia çan kokën, apo, kryet atyparitet me një sëpatë genies ca më të shkretë që na pat krejt fajin vetë përta: nuk e linte të qetë Sakaq, qarkorja e qendrës shpall të zhdukur në drejtim ta ditur këtë të ndërkyer që nuk denjoi fare të paraqitje së paku sa për të qetë i paditur dhe e bën krejt të qartë që vrasja nëpërmjet pjesës së mpredht të një arme të hekur relativisht të ftohtë e ashtuqajtur një sëpatë me myqe edhe ndarja e kokës horizontalisht më dysh e në lartësinë e qeprikëve pa asnjë mëdysheje është kryer me paraqellim të qëllimshëm

Kohë e pas kohe gazetat qendrore që s'ka ç'qulloshin përpos zisë kronike të genieve do pasqyrojnë lajmet për aq e kaq vjeçari, që është zhdukur e që s'është kthyer akoma nga drejtimi i pa ditur qysh ahere kur qëlloi me pjesën e përparme të një sëpate kaq e aq vjeçare, që, këto ditë, në bazë të datës së saj të lindjes, do t'që duke festuar ditëlindjen meqë do mbushte kaq e aq vjeç, teksa miqtë e mikeshat me pjtat në pëqi dhe qerasjet mes gishtash maniqyr do thonin: edhe njëqind!

Ndërkohë, aq e kaq vjeçari, pra ai që e qëlloi e që tani, me llogari, i binte të qe aq e kaq vjeç do të inatosur me siguri, si një kriminel që qe teksa do shihte me qesëndi viktimën e ardhëshme po të qe këtu tani-tani që, për hir të së vërtetës, duhet thënë që në fakt, aq e kaq vjeçari mbetet ende si qyshkur në drejtim të paditur, ndërkohë që kaq vjeçari që ka ditëlindjen, fatqesisht ka ndërruar jetë Qashtu siç gazetata na e kanë bërë të qartë që me pasqyrimin qysh në faqe të parë të çastit kur, genia tjetër aq vjeçare atëbotë që qenë në bashkëshortësi qëlloi për vdekje kaq e aq vjeçaren që tani prehet mu në paqe të qiellit.

Më shkas nga nëntitulli dhe trauma e paparë që paranjofton fjalja e parë e librit të parë që nis koleksionin Meduza, *Shpërthimi i gazetarisë*, në botimet Zenit: prëj goditjes së "meteorit internet" në tokë dhe numerizimi i botës e shndërrimi i biotopit informacional që kjo shkakat. Por edhe rastit të parë special kur, i pranishëm në promovim, as i kam lexuar librat përtej hedhjes një sy nën urgjencën e pagëzimit të kolanës me një emër. Në kushtet e së cilës na ndih për të dyja, referimi mitik mbi profaninim e tempullit me aktin e përdhunimit të bukurisë Meduzë prej fuqisë Poseidon dhe ngurrosja në vijim prej vështrimt sy më sy. Gjithsesi, e pranueshme kjo alibi e imja falë dorëzanie për herë të parë si bashkëbotues, Institutit politik të studimeve humane, si dhe gjenerozitetit prej Autoritetit të mediave të cilët i falenderoj për ftesën. Kësisoj, po vijoj duke e ruajtur efikasitetin që sjell paralelizimi dhe enumeracioni, me një rast prej kronikës së ditës nga një e përditshme.

Ndëhur në krye të saj, titulli: Hidhen nga kati i shtatë, gjejnë vdekjen.

Shtjellimi: Një çift të moshuarish hidhen nga kati shtatë dhe gjejnë vdekjen!

Më poshtë: Hidhen sëtoku nga lartësia, gjë që ka shkaktuar vdekjen e menjëhershme të të dyve. Policia po kërkon shkaqet e kësaj (shënimi i saj, të përditshmes).

Nuk bëhet fjalë për shkaqet e mospërfshijës mes kohëve të foljes, pra vdekjes që sikur i paraprind hedhjes në kohën e tashme, a thua se shfaqet teksa po ndodh *Live*. Në fund, shenja e piksimt: pikë. Që gjithsesi lë të hapur mundësinë dhe të sigurt gatishmërinë e gazetarisë që, nëqoftëse eventualisht do të ketë numra të tjerë të përfshirë si shkaktarë, kjo do të shkaktojë menjëherë vënien në garë se kush do të jetë më i pari për njoftimin më të fundit lajmëruës të përfshirjes në ndryshimin e rendit të këtyre numrave. Përndryshe... kaq, dhe paskëtaj lajmi heshtë... ose heshtet. Thjesht, në mungesë lëndë dhe materiali faktik që të implikojë ndonjë serial numrash. Biles, edhe numrin më të afatit progresiv të mundshëm, si për të shmangur njëkohësisht edhe plagjiaturën, sapo e vuri në përdorim gazeta konkurente, plus një specifikim interesant shtesë: Çifti i të moshuarve hidhet nga kati i tetë (megjithë dyqanet).

E këtu, gabimi te sintaksa dhe ortografia e pikësimt vjen e bëhet njësh me gjëmën dhe rrezikun e shkrehjes së beftë të së qeshurës. Gjë që, si zakonisht e për ironi të fatit, i rri aq pranë situatave ekstreme të pikëllimit. Nuk ka as kohë, në rendjen pas lajmit dhe numrave, t'i vijesh pas edhe fatit të shkronjave. Aq më pak të operosh në rendin simbolik të numrave dhe atë figurativ imagjinar, si përshembull nën gasjen : ... pasi nuk rrinë dot më brenda rrahëve të ferrit, ku kanë mbrërritur të shtatin, hidhen nga sheshpushimi i katit të tetë. Aq më pak akoma, të këshillosh se për raste çiftesë më të rinj që do mund të marrin një vendim të tillë, kati lypset të jetë përpjestueshmërisht më i lartë për të shkaktuar me siguri më të lartë atë çka ata kanë vendosur të realizojnë, kjo për shkak të vetë kondicionit fizik, normalisht më të shëndetshëm. Sidoqoftë, kur bën vaki një rast i ngjashëm rinor, zakonisht është më me interes ta orjentosh titullin drejt versionit me rimë: burri hedh gruan e vet dhe fill më pas hidhet edhe vetë. Duke qenë se zgjon dy mundësi nën një *suspansë* e papërcaktueshmëri dhe për pasojë dyfish interes. E kjo taktikë gazetarie besoj se do të jetë cekur në librin *Televizioni dhe kultura rinore*. Kurse një titull mbi hedhjen e një palë pleqsh, mund të shtyhet maksimumi deri te basti i parashikimit se ky lajm është i fundëm, i përmbyllur në vetvete, i pashitëlueshmë, pra me shumë gjasë nuk do të ketë numra të tjerë si shkaqe pas këtij akti, e për pasojë as ç'të thuhet pas tij. Dhe kështuqaj, nuk mund të hidhet dot as në bastet normale me para të opinionëve parashikuese, nga lajmet e thjeshta të gjeopolitika konspirative, tani që, me vendim nga lart, lojrat e fatit po mbyllen.

Athëherë, në shfaqje të një rangu më të lartë profesionalizmi guximtar dhe aftësië për të paraparë që s'ka dorë tjetër pas këtij akti - prej vetë faktit të kapisjes dorë më dorë si dëshmi e përplotë e vullnetit të plotë të dyshes për të ikur nga kjo botë, dhe aq më pak lidhje të tjera ekstrageografike, përpos faktit të vdekjes së menjëhershme pas përplasjes me tokën, si dhe hollësisë në lidhje me të bjtje e të afërmim, të cilët nuk ndodhen pranë meqë gjenden të shpërndarë në meridanë të ndryshëm të planetit - ja dhe titulli disi më i zgjeruar për një testatë të detajuar në lidhje me shkaku, e njëkohësisht të figurshme:

Një çift të moshuarish hidhen nga kati i tetë prej

trishtimit.

Madje, kjo e përditëshme e ka marrë të mirëqenë përfshirjen e dyqaneve të katit përdhes në llogaritjen e lartësisë së ngrëhinës sipas modelit perëndimor. Pa qenë nevoja për sqarimin e hedhjes nga kati i tetë 'megjithë dyqanet', i cili do mund të keqkuptohej si një vërvitje e përbashkuar e varfërisë tok me mirëqenjen e prosperitetin edhe mallrave, tek bien nga qielli. Gjë që jo vetëm e tejkalon trishtimin, por nuk i mjafton as mjerimi të *pauperizmit* si gjendja kronike e tij e pashpresë. Ku nuk gabon të theyejë këmbën e të hyjë as ëndrra. Që zakonisht është aq e pasur me subjekte të ngopjes e nginijes e plot bujari për barqet e zbrazët. Sepse kur mjerimi rrënoqethës rri mu ndanë pasurisë dhe dhuhmës së mondanës: kalohet në gjendjen kristaline të mizerjes. Mjeranes. Aty ku u ndal Mijeni të shihte, kur ishte ende herët dhe pothuaj ende bosh pragut matanë.

Për saktësi asnjë prej gazetave nuk do të jetë shprehur në lidhje me detajin e katit si i cilësuar i parafundit. Jo vetëm se kjo duket qartë edhe nga pamjet e kronikave televive, por edhe sepse, përveç numrit si më tërheqës për lexuesin, nuk ka kohë për të zhbëruar nëse shtesa si kat i fundit është e legalizuar apo jo, e për ta konsideruar edhe ligjërisht e përmendur korrektesisht në shtyp. Por edhe në rast se po, duhet hetuar edhe mbi hekurat përjetë e përmbi të, si qimet e derriit ku ra ngulthi dhe mbeti vetevariit trumcak i Poetit.

Gjithsesi, shpresoj që të mos kaploheni nga e njëjta marramendje ime dhe ta ruani edhe pak ekuilibrin meqë, tekefundit, këtu po bëjmë një paralele nga jeta reale, që në fakt nuk gjen lidhje të drejtpërdrejtë me librin. Besoj, as me tjetrin e kësaj kollane, *Sociologjia e televizionit*. Sigurisht që do të konsiderohej thjesht lajthitje e rëndomtë ortografike e do të ndryshohej atypëraty, pa qenë as nevoja të censurohet me urdhër - aq më pak kur censura ka kohë që realizohet përmes inflacionimit pa fre të shkrimit, pengmarrjes së shijes dhe refuzimit selektiv të "leximit" të saj - pra, do të merrej për gafë sikur shprehja e këtij lajmi kronike të qe, për shembull: Çifti dorëpërdore hidhet nga kati i shtatë i trishtimit!

Mirëpo, ca si shumë romantik ky për një lajm realiteti, siç nga ana tjetër rezultton tepër e thatë numerologjia e rendit simbolik: dyshi hidhet nga shtata ose teta dhe gjen njëshin. ***

Te ky cast i hedhjes në çift parakalohjën imazhe *frame* të kohërave. Qysh prej atij primordial adamik, kur Ai dhe Ajo vendosin vetëvrasjen e qashtërisë për një sfidë: të kapërdijnë një kafshatë të ndaluar, mbase nën kureshtjen për të kuptuar mes brenide edhe ç'është dija e pushtetit mbi ta. Nga ky ballkon i vërvitjes për në dheun poshtë, parakalohjën pamje të artit, nga Shekspiri i tragjediës romantike të ballkonatës së vet, te Hygoi epik i të mjerëve të mizerjes e te Bodleri elegjiak i kryqit mes atij spleen si gjendje e trishtimit brengosës dhe mërziisë bodleriane që edhe i lypset njeriut për të ndriçuar njohjen e njerëzores, e

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë. Kishim si shkrim kryesor një argument të publicistit Luan Rama, në modelin e tij të përgjithshëm, sa i përket shikimit historik të Mesjetës, shkruar në një formë shumë gazetareske, gjë që e bën atraktiv për publikun. "Stratitët ishin në fakt një trupë mercenarësh, por tepër të krishterë dhe nuk dyshohet që në luftën kundër turqve, ky element të ketë luajtur një rol të dorës së parë. Të detyruar të braktisnin trojet e tyre, në fillim, ata luftuan në krah Venedikut kundër ushtrive të mbretit të Francës, ku siç shkruhet në tekstet e vjetra historike, «për çdo kokë franceze, ata paguëshin 1 dukat». Megjithatë ata i shërbyen dhe republikave të tjera të veriu të Italisë apo Napolit". Mendojmë se shkrimi është faqosur mirë, por autori nuk reagoi. Me sa duket e priste botimin kohë më parë. Nga ana tjetër, si argument të dytë, patëm një temë të redaktorit që shkruante idenë për realizimin e një monografie për Ismail Qemalin, sepse një e tillë mungon ndërsa nuk reshtin akuzat ndaj tij dhe nëpërkëmbja krahas shumë dritënjëve për këtë figurë.


Interesant ishte një artikull ardhur nga publicisti i njohur Leonard Zissi, i cili na solli një argument për mënyrën sesi shikohet Shqipëria në një enciklopedi të vjetër polake të dy shekujve më parë. "Të lashtët me emrin Albania kanë quajtur edhe krahinën aziatike që shtrihet midis Iberijës dhe Detit Kaspiq, aty ku sot ndodhet Shrivani dhe Dagestani".

Redaktori dështoi me layout e tij që ta bënte si duhet të dukej emri i Tadeush Ruzheviç të shkrimi i Silvana Lekës. Redaktori i përktheu vetë poezitë, kurse përkthyesi i njohur Astrit Beqiri solli esetë. Për të ardhur keq ishte fakti se layout ynë sot e kësaj dite nuk e bën dot përshtatjen e karaktereve jo latine. Kishte dalë si mos më keq. Edhe redaktori ka faj që nuk e shqiptoi emrin..., por që lidhen disa me problemet e tij me sytë dhe limitet kur bëhet gazeta, paçka se nuk duhet shfaqësuar. Patëm kritika që ia vlen të përmenden nga disa kolegë tanë.

Vlash Prifti shkroi një artikull për Krisikon dhe u shpreh se "këto forma (të realizuara, të jetësuar në relievin e krijuesit artist Kristo Krisiko, nuk do mund të gjenin zhvillim nga një artist me formim akademik, të cilët për kohën që flitet nuk mungonin. Ajo që unë do doja është të përforcoj atë çfarë thashë më sipër, se është talenti, intuita, këmbëngulja si dhe edukimi profesional i trashëguar nga mësimdhënësi (që pati fatin t'i ketë). Aftësia e tij për të rëmbyer prej tyre edhe të pathënat të cilat kalojnë në sistemin mendor të "rxnësit" fare pa e kuptuar". Në këtë numër, për herë të parë, patëm autorin kosovar Jonuz Fetahaj dhe motivin e tij tepër të ngrohtë patriotik, që e ndërthen dhe me lirizëm dhe me dashurinë për jetën. Ndërkohë që sërish Xhelal Fejza na solli një shkrim interesant të Miljenko Jergovićit për Solzhenicinin. Interesant është se përkthyesi nuk i ndahet prej kohësh autorit kroat... "Milosao" e këtij numri ishte më e mirë se e një jave më parë.

Para se ta mbyll, më duhet ta rikthej fjalën edhe njëherë aty nga e nisëm. Si bishti qerthull i gjarpriç që i jepet kafshimit prej kokës nëpër kryet e Meduzës. Dallimin nga kuptimi i termit 'shpërthim' si vitalitet, lindje, shpërthim si i një bulbi, të shpërthimi si hedhje në erë, shpartallim, anulim, vdekje, titulli në shqip i librit *Shpërthimi i gazetarisë* e lë në pezull, të paspërthyer. Aq më mirë, për të apeluar qysh nga titulli atë që gjuha e bart dhe e përcjell mbase jo më kot si ambiguitet dhe qasje dyfishësie pozicionimi mendues, dyshues, reflektues. Siç në rastet e mbara kur gazetaria nuk qe fotografia amatore e realitetit për kronikë e thjesht për të mësuar një lajm, por vështruesja me sy të shoyer e reales, për të kumtuar me lajm e për të mëtuar prej lajmit. Ndaj, mund të quanim gazetarë e kronikanë të klasit të parë vetë Migjenin, Nolin, Konicën, apo dhe Kutelin, Koliqin, Petro Markon e Ismail Kadarenë.

Janë në botë jo pak ata që kanë kaluar nga gazetaria, kronika, pamfleti dhe editoria; nga Seïft te Ëilliam Blake e



te Ëitman, nga Hemingueji tek Orëll, Pasolini, Kamy e Markes, e me rradhë. Mirëpo, tani është gjithë e më e vështirë të shkojnë të tillë. Jetojmë me kohë në kohën e dorëzimit të gazetarisë dhe medias, nga shpërthimi i saj iniciator - si pushteti i katërt, nën atributin e zërit *voix of people* për një drejtpeshim të treshes pushtet e përkundër ushtrimit të tepërisë dhe arbitrarës dhunuese e pushtuese - tek atashimi në rradhët e mercenarizmit, në betejat e nën urdhrat e pushtetit.

E prapëseprapë, është nga media dhe shtypi ku mbarset e ngjizet edhe nevoja e rikthimit në pozitë misionares së fillimeve. Shtypi dhe media kanë përcjellë edhe valët e lirisë e humanizmit, edhe valët e të ligës model gëbelian përmes radios së nazizmit. Siç Meduza mit i dyfishtë i vështrimit e rrezikut, bukurisë dhe tërheqjes prej spektaklit të shëmtisë, parzmore mbrojtëse dhe shtizës që kall datën me kokën e mizorisë. Gazeta dhe televizioni, mes fjalës dhe imazhit, lëndës materie dhe valë, qielli dhe toke, legjitimes dhe arbitrarës, tundimit dhe ndëshkimit, është një farë çifti Eva-Adam. Bartëse e një mëkati që u përket të gjithëve, gjithaq e fajshme sa e pafajshme.

Në trajektorën e kalimit tonë të regjimeve e pushteteve të shtypjes dhe shtypit përkatës, nga bufonata pa një censurë kushedi, ama gjakmarëse, e mbretërisë, mandej te demokracia popullore e shpalljes pa liri, e tanimë në lirinë populiste të palljes me dhe pa demokraci, medias as i janë dashur këto komplikime mitike. E mbyllim kronikën këtu dhe me gjuhën e të zezën ngjyrë të saj, që ndehet nëpër ekranë e shtëpi bashkë me muzgun.

Sot e për rastin në fjalë, nga nisi edhe kjo fjalë, mund të thuhet me plot gojë se ajo, media, me ngulmimin e përditshëm, derë më derë e dorë më dorë me pushtetin, ka dorë të padukshme në valën e erës që i dha një dorë shtyes së çiftit plak të vërvitur në ajri, dorëzuar vullnetit edhe urtisë së gravitetit, kapur dora-dorës.

"Vetvrasja e trumcakut", në mjaft raste rileximesh, më ngjan se mban përbrenda edhe marazin e autorit që po vret copëra të artit të veprës së vet, duke apeluar diku më hapur e më me tepri *vullnetet e ndrydhuna* dhe emergjencën si shoqëri, për mos me mbet 'ai thumbi i ngulun në trutë e njerzisë'.

Krenar Zejno, AMA, 3 dhjetor 2018

...E meqë është kështu, e asgjë nuk ndryshon, pse e duam Ministrinë e Kulturës, a nuk do shërbente më mirë që dikasteri të ishte nën çatinë e Ministrisë së Arsimit?! Dikur e bënin kështu dhe kishte realisht një lloj impakti, e më pak fjalë, pasi Arsimin e bashkonin me simotrën e vet Kulturën...

ARGUMENT

A na duhet vërtetë një ministër Kulturë?!

NGA BEN ANDONI

Uhtë i thashë kryeministrit se Genti Cakën mund ta bënte Ministër Kulturë, nëse ai e vlerësonte aq shumë". Kjo është fjalja e Z.Illir Meta që u sfumua në mesin e shumë prej fjalëve ku publiku u mundua të perceptonte sherrin e madh aktual të Presidentit të vendit me kryeministrin Edi Rama. Por arsytimi i kryeministrit dhe pranimi i presidentit ishte trendi: kandidatura e re ishte shumë i lexuar dhe shumë i zgjuar, ndaj mund ta bëjë shumë mirë punën e kulturës!!! Por, jo Ministrin e Jashtëm.

Në fakt, debati u shua sepse të gjithë e dinë mirë se dikasteri i Ministrisë së Kulturës "nuk vlen për asgjë"

për Ekzekutivin e një kryeministri shqiptar. Që do të thotë se ministri mund të zëvendësohet ose të komandohet kushdo, që për kryeministrin e vendit, zgjidh problemet e koalicionit, por edhe të qokave të rastit. Për vetë sistemin hibrid demokratik që ka Shqipëria ky zëvendësim është normal dhe vetëm komuniteti artistik i vendit është i ndjeshëm, për pak orë deri sa gjithçka fashitet dhe shkon në vend. Kurse Ministria manovron me buxhetin e saj shumë qesharak.

Ka një listë të gjatë me emra Ministrash Kulturë që e kanë drejtuar këtë dikaster nga viti 1990 deri në ditët e sotme por janë vetëm shumë pak syresh prej tyre që mund të kujtohen për ndonjë gjë. Jo thjesht se nuk vinin mirëfilli nga kultura porse me veprimet, aktet e tyre dhe mbi të gjitha politizimin e tyre të skajshëm, e mbytën këtë dikaster për interesa meskine.

Kryeministri Rama, në përvojën e paraardhësve të tij (kur ishte Ministër Kulturë), nuk është se ndryshoi diçka përveç dukjes (ai është mjeshër për këtë) dhe çuditë me debatet, ashtu si habiti me mbështetjen e paktë të kulturës dhe konfliktet e shumta që ka mbjellë qeverisja e tij dhe që

duhet thënë se amplifikohen nga një opozitë krejt e çartur:

Por, të kthehemi në argumentin tonë: Në rastin e fundit, nëse e vlerësonte vërtetë Ministrin Kumburo, ashtu si kolegët e tjerë të saj, i takonte t'u bënte një feedback të arsyeshëm se pse i zëvendësoi dhe pse këta nuk mund të vazhdonin më tej. Por kjo nuk bëhet sepse Rama, ashtu si paraardhësit e tij, ministrinë e Kulturës e kanë konsideruar thjesht për garniturë në Ekzekutiv.

I ndjeri Sokol Olldashi, pak kohë para se të vdiste, në një takim arrinte dhe e amplifikonte gjithnjë këtë problematikë për kulturën, kuptohet këtë herë në një pozitë "komode" (ishte opozitar): Askush nga ne nuk e ka në kujdes, ndaj mos prisni ndonjë emër ministri që t'ju habisë. Kush nuk prish punë, vazhdon të plasim portofolin e Ministrisë të Kulturës ose mbyllim ndonjë vrimë politike dhe kënaqim ndonjë aleat. Këto fjalë të deputetit të PD-së të kujtohen gjithmonë kur kujton fjalë nga këto të politikanëve shqiptarë, që Ministrinë e Kulturës mendojnë gjithnjë një njeri që lexon, e që i ka dalë nami se është i lexuar por asesi një menaxher që mund t'i kthejë frymën kulturës dhe më shumë akoma t'i japë frymë impakti kulturës së kombit. E meqë është kështu, e asgjë nuk ndryshon, pse e duam Ministrinë e Kulturës, a nuk do shërbente më mirë si institucion të ishte nën çatinë e Ministrisë së Arsimit?! Dikur e bënin kështu dhe kishte realisht një lloj impakti, sepse Arsimin e bashkonin me simotrën e vet Kulturën...

(Milosao)



P

POEZIA

Haiku të afron pak me epigramat dhe autorja e njohur e përcjell më së miri këtë frymë, ku ndërthuret mjeshhtëria artistike dhe mendimi i përqendruar



Haiku i bardhë i dimrit



NGA FERIDE PAPLEKA

Shi i hollë si fletë ari
Troket në dritare -
Prag dimri

Një qiell i ulët
Re të hirta që shtohen -
Dimri erdhi pa ftuar

Fillim dimri:
Drita vjen e dobësohet:
Shpresa mpaket

Mbi tokën dimërore
Jeta harxhohet -
Sodis e trishtuar çastin

Njëra pas tjetrës
Ditët ikin më shpejt
Tashmë është dimër

Bardhësi dimri -
Ngjyrë jetëshkurtër
Që frikësohet nga dielli

Pashë ëndërr
Një jetë krejt ndryshe -
Ishte dimër

Në sytë e mi
Hëna e zbehtë
Derdh dritë argjendi

Qyteti është i heshtur
Ka rënë në gjumë
Është vërtet dimër

Me libër në dorë
Në netët e gjata
Harrohem nëpër kohë

Mes dimrit të thellë
Vizitoj të shkuarën
Me hap të lehtë

Nën plepin e fëmijërisë
Është struktur përjetë
Parajsa e humbur

Dëborë që bie
Fëmijë që luajnë
Jetë që ikën

Mes borës alpine
Një zjarr bubulak -
Mos është zemra jote ?

Qielli nuk shihet
Një parfum bore
Si ëndërr e bardhë

Një çunak që është im bir
Qesh e qesh
Bora hedh valle

Në errësirën e mbrëmjes
Yje bore -
Ëndërritje e pastër

Lulet janë vyshkur
Në saksitë me ngjyrë -
Kulmi i dimrit

Tërë pasditen
Nga dritarja
Rruga qe e shkretë

Stuhi dimri
Drurë që gremisen
Si ushtarët në luftë

Një grua imcake
E përlotur në rrugë -
Dimër është jeta

Horizonti nxin:
Matanë detit
Një pëllumb i bardhë

Dimër i pakohë:
Në shtëpinë e vjetër
Ëndërrroj dhembshuri

Eci në jetën time
Asnjë urë për të kapërcyer
Në anën tjetër

Ngjyrë e hirtë -
Dita dimërore
Pasqyrë dëshpërimi

Sytë më rrinë me lot
Brenda meje
Ka hyrë i ftohti

Faqe shkrimi :
Diell i fshehtë
Që ma ngroh shpirtin

Mbi fletën e pastër
Fjalët dalin cullake
Sido që bën dimër

Era e dimrit
Si zemërim dashurie
Që arratiset

Një rreze dielli
Troket në xhama
Është dimër

Borë alpine :
Malet kanë vënë
Kapuç të bardhë

Vetmi gruaja -
Natë e gjatë dimri
Me emrin pikëllim

Një zemër e qetë :
Çaste të ëmbla
Në acarim dimëror

Vetja ime e dytë
Ecën pa u lodhur
Unë e ndjek pas

Duart e tua
Objekt bukurie
Për dashurinë time

Ëndërr dimri :
Një fotokopje e hënës
Rri varur në mur

Lexoj në ditar
Dikush ka dhënë shpirt :
Natë dimri

Fund dhjetori
Në dritën e kalendarin,
Një vit më pak

Dritë e dobët dimri
Mjegull e dendur
Mendime të errëta

Hija ime
Lëviz në absurd:
Dimri i shpirtit afrohet

Kur kthehem pas
Ca dritëza ndizen -

Çaste lumturie

Rrugë e rrugina
Veshur me brymë dimri
Unë shkruaj haiku

Një lule e çelur
Në mes të dimrit :
Shenjë qiellore

Natë pa gjumë
Natë që nxin
Kur jam larg teje

Engjëlli i vdekjes
Përshkon mendjen time:
Ngjyrë e zezë

Dimër 2002:
Jeta ime
Rrëshqiste në humnerë

Në netët e gjata
Fytyra ime e sëmurë
Si hënë dimërore

Kjo botë pluskuese:
Kujtim i hidhur
Dimër që s'mbaron

Dashuri e humbur
Në këtë dimër
Brigjeve të jetës

Kohë dimri
Kur shoh ëndërr
Dashuria rrëqethet

Dritë e brishtë
Një flatër zogu feks
Pas xhamit të larë

Natë dimri
Qiell i yjzuar
Pranvera s'është larg

Duke soditur
Një grua që lyp
Dimri ngurrton të ikë

Një fije drite
Nuk e di nga vjen-
Fund dimri

I ftohtë therës
Akulli befasi shkrin :
Një buzëqeshje burri

Në qiellin e lartë
Retë fillojnë e zhbëhen
Dimri po largohet

Një gjeth më përshëndet
Unë hap dritaren
S'ka më dimër

Opinion *i* Ditës

Piskama ulëritëse e një nëne...

(Duke ndjekur emisionin "Koha për t'u zgjuar" të Bashkim Hoxhës, në "News 24")

Nga Ilir Çumani

(vijon nga faqja 1)

... Ajo, duke bërë publike shqetësimin që kishte, ndjehej e tëra në panik, e lodhur, e pafuqishme, e pashpresë, e pushtuar në lot, ngashërëma e vuajtje, e pamundur për t'u dalë mbanë halleve të shumta dhe vështirësive të jetës. Dukej haptazi se e kishte humbur betejën me jetën, e tashmë i ishte dorëzuar fatit...

Në emisionin mbarëpopullor "Koha për t'u zgjuar", e moderatorit Bashkim Hoxha, kjo nënë e dëshpëruar, përmes dhimbjeve e lotëve që e pengonin të ishte e kthjellët për t'u shprehur më qartë, bënte apel për cilindo që kishte mundësi, kërkonte modestisht fare pak: një ndihmë për 3 të vegjlit e saj që i rriste e vetme. Gruaja mjerane nga fshati Kallm e Vogël në rrethin e Fierit, në ato pak sekonda rrëfuar për emisionin se kishte 12 vjet që jetonte në një strehë të rrënuar, pa drita, në terrin e errësirës, pa ngrohje, me tavan të rrëzuar e të mbushur me merimanga. Ajo nuk kishte mundësi t'i ushqente as me bukë thaatë të vegjlit e saj, të cilët kishin kohë që nuk e frekuentonin shkollën, ngase atyre u binte të fikët në klasë nga të pangrënët. Kaq mundi të belbëzonte e mjera nënë, e pastaj vringthi u shkëput nga telefonata me gazetarin e njohur, duke lënë pas dhe në heshtje peshën e dhimbjes njerëzore tek të gjithë ata që e dëgjuan dhe u bënë dëshmitarë të asaj piskame ulëritëse. Në fakt, situata e djeshme për rastin në fjalë nuk do të kishte qenë shkak për ta evidentuar veçmas në këto rreshta për lexuesin, pasi siç dihet, këto drama njerëzore tashmë janë bërë kreyt të zakon-



shme në jetën tonë të përditshme. Ato dëshmojnë qartë tablonë dëshpëruese e të pashpresë, shkallën ekstreme të varfërisë në të cilën ndodhet sot një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë shqiptare. Por, ajo që më bëri përshëtytje, ishte fakti se si moderatori i emisionit Bashkim Hoxha reagoi me një ndjeshmëri të lartë njerëzore e profesionale ndaj atij rasti në bashkëbisedimin e radhës me një tjetër telefonues, i cili, pas kësaj situatë befasuese, e nisi komunikimin e tij me sharje e fyerje për X politikan opozitar dhe nga ana

tjetër, vlerësonte e mburrte Y politikan të krahut tjetër në pushtet. Telefonuesi vazhdonte në të tijën dhe ishte përfshirë i tëri në debatin për politikën e ditës dhe kjo e nxiti gazetarin të ndërhyjë duke i kujtuar bashkëbiseduesit se, a nuk do të ishte më mirë që të largoheshin nga ky debat shpeshherë i panevojshëm politik dhe të solidërizohemi të gjithë së bashku me lotët e asaj nënë që apelonte për ndihmë...!? Lutja e gazetarit, që në thelb shprehte përgjegjësinë e qytetare, ndjenjën prindërore, solidaritetin edhe aspektin human,

por edhe profesionalizëm, u duk fare qartë se nuk i bëri aspak përshëtytje telefonuesit për të ndërruar mendje... Përkundrazi! Në rrëmujën e sharjeve dhe fjalëve fyese që telefonuesi përdori në adresë të politikanëve që i kishte targetuar, ai nuk nguroi të përfshinte dhe sulmonte edhe nënën fatkeqe, e cila apelonte për ndihmë. Kjo, e revoltoi pa masë drejtuesin e emisionit, i cili me të drejtë ia mbylli telefonin duke iu drejtuar me fjalët: "...Nuk e kuptoj këtë egërsi, këtë ashpërsi...". Nuk do të dëshiroja të ndalesha

më gjatë për të analizuar reagimin qytetar, gjestin njerëzor dhe të admirueshëm të gazetarit të njohur. Sikundërse, as atë të bërë në emancipimin e vetvetes, për të promovuar dhe forcuar mekanizmat e vullnetarizimit dhe solidaritetit njerëzor, të mbrojtjes dhe fuqizimit të familjeve në nevojë. Duke marrë shkas nga ky rast, do të theksoja faktin se situata e vështirë që po kalon vendi, klima e nxehtë politike në këtë dimër të ftohtë, nuk mund të sjellë asgjë të dobishme për qytetarët që presin zgjidhje të shumë çështjeve të rëndësishme, siç është edhe lufta kundër varfërisë. Kjo tregon se sa keq politika ndikon dhe ka hyrë në jetën tonë, e cila, interferon negativisht përmes konfliktualitetit dhe urrëjtjes, luftës së pandershme dhe etjes për pushtet, me anë të së cilës ka mundur të manipulojë dhe të përçajë qytetarët e këtij vendi. Politika dhe politikanët tanë, në mënyrë të rafinuar e kanë parcelizuar të gjithë shoqërinë, e kanë dehumanizuar edhe më shumë atë, për ta mbajtur peng edhe për shumë kohë. Kjo bën që të mos jemi të kthjellët, të mos shohim me objektivitet realitetin ku jetojmë, të ardhmen dhe perspektivën tonë të përbashkët. Për sa kohë njerëzit do të jenë të ndarë në ithtarë e idhujtarë të politikanëve të pandershmë, për aq kohë varfëria dhe mjerimi si një epidemi masive do të bëjë kërdinë e ulur këmbëkryq në mes nesh, në vatrën tonë. Të humbur do të jenë njerëzit e thjeshtë, por të fituar do të mbeten përgjithmonë ata, shkakhtarët e vërtetë të dramës dhe vuajtjeve njerëzore të një populli të tërë...

Opinion i Ditës

Po boshatisemi!

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... të një të ardhmeje më të mirë në emigracion. Një në çdo shtatë shqiptarë që banojnë këtu. Ose më shumë se qarku i dytë më i madh i vendit, Fieri, që ka 304 mijë banorë. Qeveritë e këtyre 8 viteve (në fakt, jo vetëm ato, por po flasim për vitet e fundit) kanë dështuar tërësisht të na japin arsye për të qëndruar në atdhe. 362 mijë është një shifër e frikshme për ritmin me të cilin po boshatisemi si shtet. Sipas studimit të një organizate serioze joqeveritare me natyrë ekonomike, më shumë se 90 për qind e atyre që emigrojnë janë në moshë pune (madje shumica dërrmuese në grupmoshën 25-45 vjeç) dhe mbi 55 për qind me arsim të lartë ose që zotërojnë punë të kualifikuar (zanate). Sot qarku i Kukësit ka një të tretën më pak banorë nga sa kishte 5 vite më parë. Shtatë komuna të tij, ndër 10 komunat më të varfra të Shqipërisë, kanë afro gjysmën e banorëve që kishin 10 vite më parë. E njëjta gjendje dhe shifra të ngjashme, edhe pse pak më të ulëta, kanë edhe komunat e tjera të vendit, si dhe qytetet periferike. Vetëm në dy vitet e fundit, 2017-2018 kanë ikur 72 mijë prej nesh. Kush pretendon se dukuria e largimit nga vendi për arsye ekonomike është e natyrshme dhe nuk ka pse të na shqetësojë, pse kështu po ikin edhe polakët apo rumunët nga vendi i tyre, ia fut katundit. Në asnjë nga këto dy vende me emigracion të fortë të sotëm në Bashkimin Evropian, popullsia e tyre nuk shprehet në masën 60 për qind se do të lërë shtetin amë! Sipas organizatës mbledhëse opinionesh "Barometri i Ballkanit", kjo shifër 60 për qind ka ardhur duke u rritur vërtik që nga viti 2016, kur kërkonin ose planifikonin të largoheshin 48 për qind e shqiptarëve. Vetëm një vit më vonë u bë 50 për qind dhe sot është edhe 10 për qind më tepër. Kjo tregon se tek ne është vlarë shpresa. Nëse një pjesë e mirë e polakëve apo edhe rumunëve largohen me kontrata pune dhe studime, nga Shqipëria 80 për qind e të larguarve ikin nga sytë këmbët, thjesht sepse janë të varfër dhe të papunë. Emigracioni, krahas tharjes së fuqije krijuese dhe sipërmarrëse këtu, po dëmton rëndë edhe shërbimin shëndetësor në vend. Sipas të dhënave nga Urdhri i Mjekut, në katër vitet e fundit 2015-2018, e kanë lënë vendin më shumë se 600 mjekë, kryesisht kardiologë, ortopedë, pediatër etj. Përgatitja e një mjeku kërkon së paku 20 vjet vetëm arsimim, ndaj zëvendësimi i tyre është i shumë i vështirë, madje gati i pamundur. Ndërkohë spitalelet e Sarandës, Gramshit, Përmetit, Dibërës etj. ndodhen me 2-3 mjekë ose pothuajse pa stafë mjekësore. Tek ne tre janë arsyeet kryesore pse ikim: varfëria ekstreme dhe e përhapur, mungesa



e perspektivës së qartë për vende të reja pune dhe korrupsioni i pranishëm në çdo pore të administratës sonë shtetërore. Po boshatisemi, mes një ritmi lindjesh më të ulët in e 30 viteve të fundit (vetëm 7 mijë të porsalindur në vitin 2018), ngaqë me mijëra familje vendosin të mos bëjnë fëmijë, për shkak të vështirësive ekonomike. Familjet shqiptare në

emigracion linden shumë fëmijë. Janë me tre dhe katër fëmijë, pse ua lejojnë kushtet dhe perspektiva. Numri i lindjeve jashtë rrethit herë më i madh se sa këtu. Qeveria bëri shumë mirë që vendosi shpërblym për lindjet, me 400 mijë lekë të vjetra fëmija i parë dhe 800 mijë nëse është i dyti apo një milion e dyqind mijë nëse

është fëmija i tretë. Por duhet ta dyfishojë këtë shpërblym. Le të jetë masa e parë e një pakti për sjelljen e shpresës tek ne, tek ky vendi ynë që po plakët e boshatiset me shpejtësinë e dritës! Për ne, e vetmja spirancë, zinxhir që do të na mbajë këtu është kthimi i shpresës, të shikuarit e qeverisë sonë që bën kthesë 180 gradëshe, që nuk punon dhe përpqiet më për oligarkët, por për të na krijuar vende të reja pune. Do të ishte një ag shprese nëse kontratat e firmosura gjatë vitit 2018 të tre nga pesë akset e rrugëve të reja me vlerë 712 milionë euro (Milot-Baldren, Orikum-Himarë dhe Thumanë-Vorë, me vlerë afro gjysmë miliardi euro) të pezulloheshin përkohësisht (tre-katër vjet), duke i lënë Buxhetit të Shtetit mundësi të derdhë më shumë para për bujqësinë, turizmin dhe agroturizimin, prej ku mund të punësohen në po kaq vite 30 deri në 40 mijë prej nesh. Mos po shpresojmë shumë?

Sot qarku i Kukësit ka një të tretën më pak banorë nga sa kishte 5 vite më parë. Shtatë komuna të tij, ndër 10 komunat më të varfra të Shqipërisë, kanë afro gjysmën e banorëve që kishin 10 vite më parë. E njëjta gjendje dhe shifra të ngjashme, edhe pse pak më të ulëta, kanë edhe komunat e tjera të vendit, si dhe qytetet periferike. Vetëm në dy vitet e fundit, 2017-2018 kanë ikur 72 mijë prej nesh.

HOROSKOPI

DASHI

20 janari mund të jetë një ditë trishuese për të lindurit e kësaj shenje. Kjo për shkak të problemeve sentimentale që miqtë apo të afërmit tuaj do të ndajnë me ju. Megjithatë, në mbrëmje gjendja juaj do të përmirësohet dukshëm.

DEMI

Duhet të bëni kujdes se mos lëndoheni për shkak të punëve fizike apo lojtrave të ndryshme. Këtë ditë mos i zbuloni planet apo qëllimet tuaja astero mikumë i afër. Në mbrëmje mjet shansi për një takim të suksesshëm, pasi mund të takoni një zyrtar shtetëror që do tju ndihmojë në fushën që ju intereson.

BINJAKET

Binjakëve këtë ditë iu rekomandohet të kujdesen për shëndetin e tyre. Eoja në këmbë, sportet e lehta dhe konsultimet me një mjek të njohur do të jenë të dobishme. E diela nuk është dita më e mirë për të filluar projekte të lodhshme.

GAFORJA

Shfaqja e dikujt pas një kohë të gjatë apo kujtimi i një ngjarje të pakëndshme në të kaluarën do të sjellë situatë të tensionuar për Gaforët këtë ditë. Për ta kaluar më lehtë, shpenzoni më tepër kohë me fëmijët tuaj, fisni me motrat, vëllezërit ose prindërit tuaj.

LUANI

Për Luanët, dita e diel do të jetë e qetë. Do të gjeni kohë mjaftueshëm për tu relaksuar. Mundohuni të mos u përgjigjeni provokimeve nga njerëzit me mendime negative. Ngjarjet argëtuese do të jenë firmimet me seksin e kundërt, apo edhe bledhje të suksesshme.

VIrgJERESHA

Virgjëreshat këtë ditë duhet të harrojnë racionalizmin e tyre të përgjithshëm. Mos kini frikë të fisni për atë që po ndodh në shpirtin tuaj dhe mos fshihni simpatinë ndaj dikujt. Mos blini gjëra të panevojshme apo të shpenzoni shumë për pushime.

PESHORJA

Personat që do tju rrethojnë këtë ditë do të habiten nga sjellja juaj ekstravagante. Ajo çfarë nuk duhet të ndryshoni tek vetja është komunikimi. Në mbrëmje kushtojni më tepër kohë vetes, meditonit ose bëni joga.

AKREPI

Akrepët mund të jenë mërziur me jetën familjare. Përpquni të bëni diçka ndryshe për të thyer rutinën. Bëni kujdes me fjalët, pasi mund të ofendonit partnerin/partneren tuaj.

SHIGJETARI

Këtë të diel shigjetarët do të kenë nevojë për ndihmën apo këshillën e dikujt në lidhje me çështjet financiare. Beqarët e kësaj shenje do të kenë sukses në lidhje me seksin e kundërt. Ata që kanë një partner duhet të jenë të hapur për eksperimente romantike.

BRICJAPI

Për Bricjapët, kjo do të jetë një fundjavë si të gjitha ditët e tjera. Kaloni disa orë në heshtje për vjaur me mendimet tuaja. Mos i jepni asgjë këshilla dhe mos bëni premtime sot. Mbrëmja do të sjellë gëzim kur të vizitoni një person që nuk e keni parë për një kohë të gjatë.


UJORI

Ujorët rekomandohen të mendohen mirë para se të flasin. Ka gjasa që fjalët tuaja të interpretohen gabim. Dikush mund të përpqiet tju provokojë. Do të bënit mirë që të përqendroheshi në punë krijuese, pasi do tju ndihmojë shumë mirë psikologjikisht.

PESHQIT

Nëse jeni në kërkim të dashurisë, mos u shpërqendroni duke menduar për disa persona njëkohësisht. Përqendrohuni vetëm te njëri prej tyre. Do të kaloni një të diel të qetë nën praninë e të afërmeve dhe miqve tuaj.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Ferguson trainer.
- Grand Prix
- Eshtë stacion beduinësh.
- Një artikull jo për vegjetarian
- Kuji i vjen... di të bëjë.
- Kaçaturian kompozitor
- Logot pa kujfij
- Parashtesë për vetë.
- Aktorja protagoniste e Vertigo.
- Ndezur në aparaturë.
- Eshtë si telefilm.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Eshtë me shumë se kërkese.
- Cristiano bomber te Real Madrid.
- Teket e grave.
- Në krye të masave.
- Shkon goja... nga nepsi.
- Duken të gjata ato të prijës.
- Gjysmë bataku.

- Eshtë për medaljen e parë
- Eshtë kujdesi i babait.
- Maiden që këndojnë.
- Një "bombë" tenistike.
- Fillojnë mykjen
- Janë këngëtarët si Jose Carreras
- Eshtë këngë e kënduar nga komiku
- Lumë në Francë.
- Piktori i Ura e Narnit.
- Kapen në kujfij

VERTIKAL

- Në hyrje të ambientit
- Neeson aktor.
- Ente Sociale Rumune.
- Ajo e zezë nënkpton arbitrin.
- Kufizojnë stacionin.
- Tremb fëmijët.
- Jepet për t'u marrë.
- Qytet japonez.
- Eshtë pemë
- Janë tallësit.
- Roberto trainer italian.
- Freni këngëtare lirike.
- Gjysmë totale.
- Një si divan.
- Tipare pa zë
- Ulet në dhomën e lartë.
- Moore aktor.
- Qe bomber brazilian.
- Ishte shpërthimi i Little Boy.
- Carolina, e bukura e Belle epoqe.
- Mbarojnë fare
- Pullman aktor.
- Eshtë thëllimi
- Meg aktore.
- Ndërmarrje Industriale Rajonale.
- Një lidhëz.
- Kaluar në krye.
- Fundi i Turandot.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Mund të hidhet te kiromanti
- Teket e kafes.
- D'stria e Helena Gjikhës
- Smith filozof.
- Kuku regjisor
- Një pjesë e minoritetit.
- Moduli i Neil Armstrong.
- Mund të jenë qitjeje.
- Markë pistolete.
- Mbyllin fushatat.
- Eshtë dorëzim.
- Eshtë detar.
- Fillojë ilustrimet.
- Eshtë hon.
- Diftong në duel
- Një pjesë e rifillimit.
- Një që kuron karien.
- Nganjshëherë duhen vënë mbi.
- E egër dhe e fortë.

VERTIKAL


- Janë thënie e famshme.
- Janë trupa qëllorë të tillë.
- Inicialet e Stone regjisor
- Memoria në computer
- Në krye të trupave.
- Mund të jenë diskografike.
- Eshtë e zakonshme për pushime
- Skuadër greke.
- Bel i Maupassant.
- Eshtë thesar.
- E famshme ajo maqedonase.
- Një zakon.
- Bëjnë alarm me ar
- Inicialet e Mallë regjisor
- Mund të jetë telefonike
- Ka dy faqe
- Mund të jetë një cutter.
- Në mes të dhomës.
- Mbahet me bateri.
- Përfshijnë edhe Haitin.
- Denis i enëve me presion.
- Paguhen për shërbime.
- Janë ufo.
- Ekstremit në tunel.
- Një atentator vetëvrasës.
- Markë cigaresh.
- Arrihet duke mundur.
- Jonathan, regjisor i Heshnja e qengjave.
- Eshtë aparati me zorrë.
- Pak servilizëm.
- Kështu e ka syrin vigjilenti.
- Fatih trainer turk.
- ... Nostra me mafiozët.
- Mbyllin punimet.
- Ai i shenjtë është papa.
- Kufizojnë në teknik.
- Fillojnë panikun.
- Fund tuneli.
- Në krye të armatës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|--|
| | | 3 | | | | 7 | 2 | 5 | | |
| | | 9 | | 7 | 8 | | | | | |
| | | | | 1 | | 8 | | | | |
| | | | | | | | | 5 | | |
| 4 | | | | | | | | 1 | 9 | |
| | 2 | | 8 | | 9 | | | 4 | | |
| 3 | | | | 5 | 2 | 1 | | | | |
| | | | 1 | 6 | | | | | | |
| 7 | 9 | | | 8 | 3 | 5 | | | | |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|--|--|
| 4 | 1 | 6 | 2 | 3 | 8 | 5 | 7 | 9 | | |
| 5 | 3 | 8 | 7 | 4 | 9 | 1 | 6 | 2 | | |
| 2 | 7 | 9 | 5 | 1 | 6 | 3 | 4 | 8 | | |
| 6 | 8 | 1 | 3 | 2 | 7 | 9 | 5 | 4 | | |
| 7 | 9 | 4 | 8 | 5 | 1 | 2 | 3 | 6 | | |
| 3 | 5 | 2 | 9 | 6 | 4 | 7 | 8 | 1 | | |
| 9 | 6 | 3 | 4 | 7 | 2 | 8 | 1 | 5 | | |
| 1 | 2 | 5 | 6 | 8 | 3 | 4 | 9 | 7 | | |
| 8 | 4 | 7 | 1 | 9 | 5 | 6 | 2 | 3 | | |

Argëtim filozofik

- Gabimi më i madh për ne, është të pranojmë një gabim që nuk e kemi bërë.

- I talentuari bën atë që mundet. Gjeni bën atë që duhet.

- Miq të mirë, është e vështirë për ti gjetur, akoma më e vështirë për të braktisur ata, dhe është e pamundur për ti haruar ata.

- Rruga drejt suksesit është gjithmonë në ndërtim e sipër.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|----|----|----|----|----|----|----|---|----|----|----|----|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 9 | 3 | | 11 | 5 | 9 | 6 | 11 | 1 | 4 | 3 | R | A | S | T | E | T | P | A | P | | |
| 12 | 16 | 15 | 17 | 6 | 11 | 15 | | 4 | | 12 | 2 | U | R | A | T | U | R | H | P | A | | |
| 6 | | 1 | 4 | 12 | 6 | 11 | 5 | 18 | 11 | 2 | 9 | S | A | M | M | A | R | A | I | S | | |
| 17 | 18 | | 5 | 4 | 12 | 6 | 1 | 4 | 14 | 2 | 3 | I | A | M | E | R | I | K | A | N | E | T |
| 2 | | 1 | 7 | 3 | 2 | 9 | 7 | 9 | 2 | 3 | | P | R | O | T | E | S | T | A | N | T | E |
| 14 | 4 | 1 | 7 | 9 | 4 | 3 | 7 | 9 | 2 | 3 | | G | J | I | G | A | N | T | I | I | R | U |
| 18 | 4 | 6 | 9 | 5 | 4 | 12 | 3 | 7 | 9 | | | B | E | T | O | N | E | K | B | O | R | |
| 9 | 2 | 12 | 2 | 4 | 12 | 3 | 9 | 2 | 18 | | | S | A | L | I | R | A | M | A | | | |
| 4 | 8 | 2 | 3 | | 8 | 6 | 6 | 6 | 16 | 15 | | T | O | N | T | I | T | U | L | L | I | |
| 5 | 4 | 12 | 3 | | 11 | 2 | 5 | | 3 | 6 | 12 | A | R | E | S | A | O | | | | | |
| 15 | 3 | 6 | | 1 | 2 | 3 | 4 | | 3 | 2 | 11 | P | J | A | R | Z | O | T | I | M | I | |
| 17 | | 9 | 9 | 15 | 16 | 4 | | 4 | 9 | 3 | 2 | A | A | M | E | R | E | N | G | U | E | S |

PËRÇJQJËT E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

PËRÇJQJËT E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Thënie të mençura

- Një lutje nuk ndryshon asgjë, por një vendim mund të ndryshojë çdo gjë!
- Nëse njerëzit flisnin vetëm për atë që ata kuptojnë, heshnja që do të mbizotëronte në botë do të ishte e padurueshme.
- Kur virtuti ka rënë në gjumë, do të zgjohet më i fresket.
- Kush ul veten kërkon të ngrihet.
- Mjeti kryesor i të gjitha magjepsjeve është ai i të shtënit në dorë të diçkaje që i përket një tjetri.
- Varësia e opinioneve, e shëndërruar në instinkt, falë zakonit, çon drejt asaj që quhet forcë karakteri.

